

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSIT



FAKULTETI I GJUHËVE, KULTURAVE
ЕВРОПА ДНЕ КОМУНИКИМИТ
GJUHË, KULTURË DHE LETËRSI SHQIPE

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

INTERTEKSTI NË ROMANIN” DERVISHI DHE VDEKJA” TË MESHAS SELIMOQIT

Kandidati:
Doc.dr. Meral Veseli

Mentori: Xhejlan Xhelili

Tetovë, 2020

Lois McMaster Bujold¹,

“Të vdekurit nuk mund të bërtasin për drejtësi.

Kjo është një detyrë e të gjallëve për ta bërë këtë

për ta”.

¹ Lois McMaster Bujold- shkrimtare amerikane (2 nëntor 1949)

DEKLARATA E AUTORIT

Unë, Xhejlan Xhelili, studente pranë Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në Universitetin e Europës Juglindore- Tetovë , deklaroj se jam autore e punimit dhe mbaj përgjegjësi për origjinalitetin e të njejtit.

Xhejlan Xhelili

Lektoroi :

Doc.dr. Luljeta Adili-Çeliku

FALËNDERIME

Fillimisht dua ta falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për mentoren time doc. dr. Meral Veseli, për mbështetjen e vazhdueshme që më ka dhënë gjatë përpilimit të kësaj teme, e cila me shumë përkushtim dhe durim më udhëhoqi nëpër labirintet e këtij punimi modest shkencor që, sigurisht, nuk do të ishte strukturuar, gdhendur, dhe më tej, përmbyllur kësisoj, pa ndihmën e saj të madhe dhe të pakursyer.

Falëndëroj përzemërsisht gjithë anëtarët e familjes sime, prindërit dhe gjithë kolegët e mi të fakultetit të filologjisë me të cilët ndaj kujtime të mira. Falemndëroj stafin akademik dhe administrativ të fakultetit për ndihmesat e gjithanshme.

Titulli i temës:

“INTERTEKSTI NË ROMANIN DERVISHI DHE VDEKJA TË MESHA SELIMOVIQIT”

Përkthimi i titullit në maqedonisht:

“ИНТЕРТЕКСТОТ ВО РОМАНОТ *ДЕРВИШИ И СМРТА* ОД МЕША СЕЛИМОВИЌ”

Përkthimi i titullit në anglisht:

“INTERTEXT IN THE NOVEL *DERVISHI AND DEATH* TO MESHA SELIMOVIQ”

Abstrakti në shqip

Studimi mbi intertekstin dhe tekstin në romanin “Dervishi dhe vdekja” të autorit Mesha Selimoviq, në kohë dhe rrethana të tjera historike, paraqet një ndërmarrje të vështirë për studim. Romanin e tij, do të përpiqemi ta perceptojmë ndryshe, ndryshe nga një lexim i thjeshtë dhe analizë ritreguese, por duke u ndaluar dhe studiuar intertekstin e saj, tekstin brenda tekstit romanor, që më nxiti realisht dhe kureshtjen kodzbërthlyese të kësaj krijimtarië, që depoziton brenda teksteve dhe nëntekteve poetike shtresime kuptimore të larmishme.

Mungesa e studimeve për këtë autor, mungesa e analizës së veprës së marrë për studim shton përgjegjësinë përpara një studiuesi të veprës së tij, në rastin tonë asaj të Mesha Selimoviqit, sepse tendenca e tij bëhet pikë fillestare referimi për studiuesit e ardhshëm. Tematika që shfaqet në veprat e tyre është kryesisht e mbështetur mbi bazën kulturore, zakonore, shoqërore e sociale të Ballkanit, rrjedhën e jetës ballkanike në shekuj, duke filluar që prej gjendjes së Ballkanit nën pushtimin turk, luftërat ballkanike, Luftën e Parë e të Dytë Botërore, sistemet e realizimit socialist duke arritur deri në kohët e sotme moderne. Në veprat e tyre ata pasqyrojnë karakterin ballkanas.

Abstrakti në gjuhën maqedonase

“ИНТЕРТЕКСТОТ ВО РОМАНОТ *ДЕВИШ И СМРТА* ОД МЕША СЕЛИМОВИЌ”

Студирањето на интертекстуалноста и текст бо романот „Дервиш и смртта” од авторот Меша Селимовиќ во времето на други историски околности, претставува тешко преземање за студирање. Во неговиот Роман ќе се обидеме да го дефинираме поинаку од едно обично читање и анализа на раскажувањето, но почнувајќи да претстанува да се проучува својата интртекстуалност текстот во рамките на текстот во романот што навистина ме мотивираше и љубопитноста на овој растворливо создавање што допира во внатрешноста на текстот и поетски поттекст на семантички слоеви разновидени.

Недостаток на студии за овој автор недостиг на преземаната анализа на делото за студирање додава одговорност преку еден научник за своето дело во нашиот случај тоа под Меша Селимовиќ затоа што неговото тенденција станува почетна точка за идните истражувачи. Темите што се појавуваат во неговите дела главно се заснова на вообичаени социјални и културни темели на Балканот во текот на вековите од балканскиот живот од државата на балканиот под турска окупација до балканските војни до денешно време. Во нивните дела тие го отсликуваат балканскиот карактер.

Abstrakti në anglisht

“INTERTEXT IN THE NOVEL *DERVISHI AND DEATH* TO MESHA SELIMOVIKIQ”

The study of text and intertextuality in Mesha Selimovic's novel „Death and the Dervish”, in time and other historical circumstances, presents a challenging endeavor. Ëe ëill try to perceive his novel differently, by focusing on and studying its text, ëich really inspired my coriosity about this enigmatic novel, that lays ëithin poetic and subtext, diverse contextual layers. Rather than mere reading and retelling analysis.

The lack of studies on this author and the lack of analyses of the ëork taken for study, adds to the responsibility of a researcher of his ëork, in our case, that of Mesa Selimovic, because his tendency becomes the starting point of reference for future scholars. The themes that emerge in their ëorks are largely based on the cultural, customary and social basis of the Balkans under Turkish occupation, continuing on to the Balkan Ëars, the First and the Second Ëorld Ëar, Socialism, and reaching up to present-day. In their ëorks, they illustrate the Balkan character.

PASQYRA E LËNDËS

FALEMINDERIME.....	4
Abstrakti në shqip	6
Abstrakti në gjuhën maqedonase	7
Abstrakti në anglisht	8
PASQYRA E LËNDËS.....	9
HYRJE.....	11
Qëllimi i studimit	16
Qasja teorike	17
Hipotezat.....	20
Metodologjia e hulumtimit	20
Rëndësia e punimit	21
KREU I.....	22
I.1 LETËRSIA DHE FILOZOFIA, RAPORTI I LETËRSISË ME BEKTASHIZMIN DHE SUFIZMIN	22
I.2 BOTA EKZISTENCIALE DHE METAFIZIKE	24
Kreu II	31
II. 1. ANALIZA E ROMANIT “DERVISHI DHE VDEKJA”.....	31
Kreu III.....	46
III.1 PERSONALITETI I AHMED NUREDITIT.....	46
III.2 3D-JA E NJË PERSONAZHI.....	50
III.3 PERSE DHE KUJT I RRËFEHET NURUDINI?.....	52

III.4 PERSONAZHET E TJERA NË ROMAN	58
Kreu IV	60
IV.1 INTERTEKSTI KURANOR NË ROMAN	60
IV.3 NGJASHMËRITË E ROMANIT ME VEPRA TË TJERA	62
KREU V	64
V.1 HUAZIMET TURKE NË ROMAN SI INTERTEKST	64
V.2. KRAHASIMET E SHPESHTA QË I GJEJMË NË ROMAN.....	68
PËRFUNDIMI	69
Bibliografia	72
BURIME NGA INTERNETI	74
BIBLIOGRAFIA PLOTËSUESE.....	74

HYRJE

Një studim i mirëfilltë për elementet intertekstuale në romanin e shkrimtarit të njohur ndërkombëtarisht Mesha Selimoviq, “Dervishi dhe vdekja” dhe nxjerrja e konstatimeve të qëndrueshme, të mbështetura në dijen shkencore dhe shkrimet paraprake, në kritere dhe në një sistem parimesh teorike-estetike-kritike, vazhdon të jetë dëshirë për studim nga kritika letrare kudo në letërsinë ballkanike dhe ato shqiptare. Në të vërtetë brenda tyre ka shumëçka metaforike dhe thelbësore njëherësh, ngaqë pikë së pari duhet ta marrim parasysh faktin se letërsia ka përkatësi individuale, sepse lind dhe jeton pikërisht nga *qenia shpirtërore e njeriut* që është lidhur me të, si dhe që ka dhunti për ta krijuar në formën e ndonjë veprë letrare ose për ta interpretuar. Së këndejmi, një studiuesi nuk i mbetet veçse t’i qaset studimit me ndjenjën se gjithmonë mund të vë *letërsinë në rrezik*, sikundër thotë Cvetan Todorov.

Siç u theksua edhe më lart, vepra e marrë në analizë përbën një lloj të veçantë të ndërtekstorësisë, e cila lidhet me kontaktet e brendshme që ka korpusi brenda tij. Përmes kësaj analizë strukturaliste të veprës artistike, romani në fjalë komunikon mes tyre së brendshmi dhe karakterizohen prej lidhjeve e ndërveprimeve të brendshme, të cilat ndërthuren e gjallërojnë nga njëra ngjarje në ngjarjen tjetër.

Studimi i këtyre kontakteve dhe ndërveprimeve brenda korpusit të gjitha ngjarjeve brenda romani mund të çojë në analizime të thella të kësaj dukurie, duke vëzhguar dhe duke ndjekur ligjësitë e saj. Më poshtë do të renditim dhe shqyrtojmë, në vija përgjithësuese, pika të cilave do u rreferohemi me detajisht më poshtë në punim, por por paralajmërojmë se disa elementet struktururore brenda veprës kanë kontakt mes syresh:

- ngjarjet që rrjedhin prej njëra-tjetrës:

– ngjarja e këtij romani u ndërftua sufizimi dhe Kuranin si libër i shënjtë, duke u trajtuar si ngjarje e ndodhur në Bosnjë; romani mund të merret si variant i rrëfimit si tek “I huaji” i Kamysë, Rrëfimet e Shën Agustinit, etj vepra që kanë personazhe të njëjta, në aspekt të besimit, - vepra ka personazhe që nuk kanë qëndrim, vepra ka zë ose hije – personazh

(...)Kontaktet gjenetike që krijon ky roman me veprën e autorëve të tjerë, kryesisht të shkrimtarëve më të mëdhenj të letërsisë botërore, mundëson shfaqjen e ndërtekstorësisë dhe ekzistencën e fenomenit të huaj letrar në veprën e tij. Këto kontakte letrare ose dhe jashtëletrare, sipas rastit, i shërbejnë dhe i paraprijnë marrëdhënieve artistike. Kontaktet që evidentohen parakuptojnë lidhjet gjenetike me origjinalin (paratekstin), duke gjalluar brenda korpusit letrar të Mesa Selimoviqit shpesh edhe si ndikime të pandërgjegjshme, duke u shfaqur si cilësi organike e veprës letrare. Ndërtekstorësia jashtë veprës në romanin “Dervishi dhe vdekja” duhet parë në dy aspekte, si: - ndikim ndaj shkrimtarëve botërorë (ndërtekstorësi e brendshme – me faktorë letrarë) -, ndikimet nga Sufizimi, ndikimet nga Kurani, ndikimet nga ëndrrat, - ndikimet nga tejhujsimi – Kamy. etj. Këto ndikime rrjedhin prej ligjësorive të brendshme të procesit letrar, kushteve të ngjashme ose të përafërta shoqërore (rasti me Kamynë) ose dhe si ndikime të qëllimshme (Kurani); - ndikimet nga mitologjia (si ndërtekstorësi e jashtme), ndikimet nga mitet.

Në këtë punim, në vend të fjalëve të huaja intertekstualitet dhe hipertekstualitet do të përdoren gjegjëset e tyre në shqip: ndërtekstorësi dhe mbitekstorësi, vetëm në rastet kur i referohemi studiuesve që janë marrë me analizimin e tyre, do të përdoren ashtu siç ata u janë referuar. Interteksti është term i përdorur prej G. Genette, për të kuptuar lidhjet mes një teksti dhe një parateksti (hipoteksti) - teksti në të cilin është bazuar. Genette përdorte termin transtekstualitet dhe dallonte pesë tipa të tij: intertekstin, paratekstin, metatekstin, hipertekstin dhe arkitekstin. Sipas M. Bakhtinit koncepti i intertekstit është thujse i barasvlershëm me parimin dialogjik ose edhe polifonizmin.²

Në romanin “Dervishi dhe vdekja” autori trajton jetën e protagonistit Ahmed Nuredinit, i cili has në jetë vështirësi të mëdha. Përjeton ngritje dhe shkatërrim si dhe anasjelltas. Fajson veten e tij pasi nuk dinte arsyen e burgosjes së vëllait të tij. Gjithashtu, trajtohen tema për vështirësitë e popullit të Bosnjës, vuajtjet e tyre por edhe shpresa për ditë më të mira është e pranishme në çdo kohë. Në çdo kapitull të veprës ka një varg kuranor si dhe

²Linda Hutcheon, (1989) “Historiographic Metafiction: Parody and the Intertextuality of History.” Intertextuality and Contemporary American Fiction. Ed. P. O'Donnell and Robert Con Davis. Baltimore: Johns Hopkins University Press, f. 3-32

vërehet edhe në shumë faqe të romanit dhimbja e madhe për vëllanë e tij të vdekur. Kishte gjithmonë njerëz të pakënaqur dhe të paplotësuar, por kishte edhe njerëz që ishin në gjendje ta shihnin jetën në anën tjetër - më të plotë, më të gjallë dhe të gëzuar.

Mesa Selimoviq, bën pjesë ndër figurat më të shquara të kulturës dhe të letërsisë boshnjake dhe ballkanike. I rritur e i formuar nëpër qendrat më të njohura të kulturës dhe letërsisë boshnjake, në Tuzlla, që i paprekur nga hatri i rremë dhe konformizmi ballkanik. Për të, me gojën plot mund të konstatojmë se është shkrimtari më i madh i letërsisë së Bosnjës dhe Hercegovicës dhe i letërsisë ballkanike, ai është një disident i llojit të veçantë, autor pa të cilin dhe letërsia e kësaj anë do të ishte me pak e njohur.

Mesha Selimoviç shkrimtar boshnjako-sërb lindi, më 26 prill 1910 në Tuzëll, ku kreu shkollën fillore dhe gjimnazin. Në vitin 1930 i vazhdoi studimet në fakultetin filozofik në Universitetin e Beogradit, ku edhe diplomoi në vitin 1934. Dy vitet e fundit të luftës i kaloi në Tuzëll, ku edhe u burgos për shkak se bashkëpunonte me një grup që kërkonin lirinë popullore të Jugosllavisë.

Në vitin 1944 u shpërngul në Beograd, ku pati funksione të larta politike e kulturore. Në Sarajevë punoi si profesor i një shkolle të larta pedagogjike, si drejtor i teatrit popullor etj. Në vitin 1971 doli në pension dhe u kthye sërish në Beograd, ku edhe vdiq, më 11 korrik 1982.

1. **“Heshtja”**-1961
2. **“Vendi i huaj”**-1962
3. **“Mjegulla dhe hëna”**-1965
4. **“Dervishi dhe vdekja”**- 1966, roman i shkruar si reagim ndaj regjimit të atëhershëm të Josip Broz-Titos³. Dedicuar gruas së tij Darka, e cila gjithë jetën kishte qenë shoqe, bashkëshorte, frymëzuese dhe përkrahësja e tij e vetme. Me këtë vepër autori tregoi sfillitjen më të madhe shpirtërore dhe ndjesinë e pamasë të fajit ndaj vëllait të tij të vrarë në Goli Otok.

³ (7 maj 1892-4 maj 1980)-komunist jugosllav dhe kryetar i ish-Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë

Gjatë punimit si detyrë hulumtuese mbetet: të zbardh një ndër çështjet e pastudiuara sa duhet të romanit “Dervishi dhe vdekja” nga Mesha Selimoviq, romansierin më të mirë ballkani; të dëshmoj se ai është shkrimtar dhe i realizuar, i cili ka lënë pas vetes disa vepra të arrira, që kapërcejnë pragun e standardit të kombit dhe sot i takojnë letërsisë botëror...; të dëshmoj me argumente shkencore se në fushën e letërsisë Mesa Selimoviq, më këtë roman kapi nivelet e letërsisë më të arrirë ballkanike (...); të dëshmoj se gati të gjitha mendimet lidhur me romanin dhe intertekstin kuranor për studim janë paraqitëse dhe shumë pak thelluese dhe se e njëjta meriton vëmendje shkencore.

Studimi ynë do të dëshmojë se Mesa Selimoviq: meriton një qasje shumë më serioze, më profesionale, pse jo, edhe më dashamirëse, sepse ka lënë pas një vepër grandioze e të vlefshme që edhe në shekujt që vijnë do t’i bëjë nder letërsisë së shtetit të tij dhe asaj ballkanike.

Ky punim me qëllim të sjellë një risi shkencore. Teksa shkruaja për këtë temë me vinin ndërmend fjalët e nënvizuara nga romani: **”Të harrosh mirësinë i shtyrë nga pabesia, intriga dhe shpërfillja njerëzore“** ka për qëllim të jepë pak shpresë dhe të nxisë lexuesin mbi letërsinë ballkanike, letërsi, e cila nga shumica e njerëzve apo edhe e lexuesve të kategorive të ndryshme (mësues të shkollave fillore dhe të mesme, profesorë, studentë, mjekë, inxhinierë, politikanë), nuk pranohet si e tillë për shkak të veprave që kanë bërë të njëjtët shkrimtarë, jashtë shkrimit. Por përderisa neve na intereson vetëm letërsia, nuk duhet të merremi me atë se çka kanë bërë ato në jetën e përditshme dhe çfarë vendimesh kanë marrë, pasi me dënimet e tyre duhet të merren organe të tjera dhe sigurisht edhe të paguajnë për to.

Letërsia ballkanike është një letërsi e përfaqësuar nga shkrimtarë që nëpërmjet artit të tyre kanë zënë një vend të rëndësishëm në letërsinë botërore. Tematika që shfaqet në veprat e tyre është kryesisht e mbështetur mbi bazën kulturore, zakonore, shoqërore e sociale të Ballkanit, rrjedhën e jetës ballkanike në shekuj, duke filluar që prej gjendjes së Ballkanit nën pushtimin turk, luftërat ballkanike, luftën e parë e të dytë botërore, sistemet e realizimit

socialist duke arritur deri në kohët e sotme moderne. Në veprat e tyre ata pasqyrojnë karakterin ballkanas.⁴

Katër shekuj e ca pushtimi osman, që iu mbi vunë shekujve të pushtimeve e të sundimit të Perandorisë Romake e Bizantine, lanë vrugë të thellë në historinë e shumë popujve, të cilët ballafaqoheshin në situatën e re të përçarë, pa shkollë kombëtare, pa fe, pa një qendër të rëndësishme politike, intelektuale e kulturore, pa një udhëheqës trim për t'i shpënë ata përpara e për ta larguar armikun, pa një dorë mbështetëse, pa një diell ngrohës, pa një fjalë motivuese, pa një zgjidhje, pa një mundësi shpëtimi dhe pa një vetëdije kombëtare. Ata nuk kishin asgjë tjetër pos rrobave të arnuara në trup dhe frymës që i mbante gjallë, ndoshta edhe me ato pak ëndrra, të para në netët e trishtueshme, për një të ardhme më të mirë e më të ndritur për brezat pasardhës.

Jetojmë në një kohë kur nëpërmjet librit i afrojmë hapësirat e botës, duke e bërë atë të jetë sa më pranë nesh dhe ne të dimë për shkrimtarët dhe vendet ku nuk kemi menduar ta dërgojmë as mendjen tonë. Libri, gjegjësisht vepra përmbledh në një vështrim të arsyetuar çdo gjë që ekziston rreth autorit dhe veprës së tij letrare, duke e bërë këtë me qëllim që ta përqëndrojë lexuesin te informacionet e pa dëgjua më parë.

Ndodh shpesh që kur dëgjojmë për emrin e një shkrimtari të huaj, ne të sjellim në mend menjëherë gjërat e tjera përpos letërsisë që i dimë për të dhe në këtë mënyrë ta largojmë nga vetja edhe librin e tij, me një kopertinë, e cila në të shumtën e rasteve e tërheq vëmendjen tonë, por duke mos marrë guximin të shohim se çka në të vërtetë mund të ketë krijuar ai shkrimtar në atë vepër dhe me çka ka hyrë në radhët e letërsisë botërore. Kjo ka të bëjë me faktin se ne akoma nuk mund të pranojmë të shohim ato pak gjëra të vlefshme e të bukura në një grumbull të gjërave të këqia e të dëmshme për rrethin e ngushtë apo atë shoqëror, pasi siç e dimë, qenia njerëzore është e dhënë më tepër nga e keqja se sa nga e mira. Dhe kur ky fakt dihet nga çdokush, nuk e di se përse nuk i hedhim hapat e parë për ta ndryshuar këtë gjë dhe të pranojmë pranë vetes vetëm gjërat e bukura, për ta bërë botën më të bukur dhe me elemente tërheqëse për të tjerët.

⁴ Arlind Farizi, (2019), *Letërsia e Evropës Juglindore 1*, Syth, Tetovë, f.128.

Përderisa ne sot jetojmë në një kohë kur mund të furnizohemi me libra në çdo kënd të qyteteve, të kemi mundësi të lexojmë çdo gjë dhe të japim mendimet tona, duhet të pajtohemi me faktin se edhe gjërat e hidhura janë pjesëmarrëse aty, dhe se ato nuk duhet të jenë pengesë dhe shtysë e jona për ta flakur tutje një libër, i cili pushton libraritë botërore dhe të tjerët më parë se ne e kanë të njohur një emër dhe dinë disa specifika të shkrimit të tij. Edhe ne duhet të ndjekim hapat e botës dhe të mos merremi me asgjë tjetër përpos letërsisë, nëse e kemi atë qëllim kryesor për një punim apo thjeshtë për të kaluar kohën me një mik të mirë dhe të pamposhtur, siç është libri.

Duhet të mendojmë pozitivisht dhe të tillë ta kemi edhe jetën.

Qëllimi i studimit

Studimi mbi intertekstin dhe tekstin në romanin “Dervishi dhe vdekja” të autorit Mesha Selimoviq, në kohë dhe rrethana të tjera historike, paraqet një ndërmarrje të vështirë për studim. Prandaj, kur studiojmë këtë vepër gjeniale i besojmë dhe Bartit kur thotë se: *“Të lexosh do të thotë ta dëshirosh veprën, do të thotë të duash të jesh vepra, do të thotë ta refuzosh ta dyfishosh veprën jashtë çdo të folurit tjetër pos të folurit të vetë veprës (...) Të kalosh nga leximi në kritikë do të thotë ta ndryshosh dëshirën, do të thotë ta dëshirosh jo më veprën, por ligjërimin e vet (...) Sa shkrimtarë kanë shkruar vetëm se kanë lexuar. Sa kritikë kanë lexuar vetëm për të shkruar”*⁵.

Romanin e tij, do të përpiqemi ta perceptojmë ndryshe, ndryshe nga një lexim i thjeshtë dhe analizë ritreguese, por duku e ndaluar dhe studiuar intertekstin e saj, tekstin brenda tekstit romanor, që më nxiti realisht dhe kureshtjen kodzbërthyesë të kësaj krijimtarië, që depoziton brenda teksteve dhe nëntekteve poetike shtresime kuptimore të larmishme. Mungesa e studimeve për këtë autorë, mungesa e analizës së veprës së marrë për studim shton përgjegjësinë përpara një studiuesi të veprës së tij, në rastin tonë asaj të Mesha Selimoviqit, sepse tendenca e tij bëhet pikë fillestare referimi për studiuesit e ardhshëm. Shkrimtarëve të brezit të tij iu desh jo vetëm të kënaqnin pritjet e lexuesve, duke u rrëfyer për

⁵ Rolan Bart, *Aventura Semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008, f. 208.

ngjarje dhe realitet që i njihnin, por edhe t'u ofronin diç më shumë se sa kaq: *romanesken në një vepër prozaike, për aq sa mund ta receiptonte niveli i tij intelektual dhe kulturor. Ata kërkonin lexuesin paramodel, atë lexues që përjeton kënaqësi estetike nga bota e sajuar prej shkrimtarit dhe jo lexuesin empirik, pra lexuesin që "prish"*⁶.

Qasja teorike

Në aspektin teorik dhe gjithmonë duke i ndejtur besnik teorisë së intertekstualiteti dhe ilustrimeve të cilat do nxjerrim nga romani, do të trajtojmë dhe teoritë tjerë që do na shërbëjnë si ndihmesa shkencore për të realizuar në fund qëllimin final të temës. Në romanin e vetëm të marrë në analizë "Dervishi dhe vdekja" nga Mesha Selimoviqit, që u shkrua në një periudhë luftërash ballkanike me një izokronizëm të dukshëm të ndjesisë së viktimave të shkaktuara nga lufta, vërehet një strukturë lineare, e cila evoluon gradualisht drejt një stili dhe strukture të veçantë poetike të pasur me elemente intertekstualiteti. Selimoviqi vjen në roman me të drejtën për të transformuar: kuptimet, figurat, situatat dhe gjendjet afektive. Poetika e romanit të tij arrin të ndryshojë në diskurse trajtat poetike të mendimit duke krijuar një neotekst në përputhje me momentet historike, psikologjike e metafizike të narratorit - personazhi të tij, Ahmed Nuredinit.

Vetëdija krijuese e M. Selimoviqit, nuk është gjë tjetër, veçse një qartësi tekstuale dhe intertekstuale: për frymëzimin poetik, mesazhin ideor, figurën dhe ndërtimin e raportit me receiptuesin, të cilin duhet ta deshifrojmë në këtë studim. Studimet e deritanishme nuk kanë prekur sa duhet tekstin dhe intertekstin poetik të këtij autori në përmasat e një krijimtari universale dhe këtë do përpiqemi t'a bëjmë përmes studimit të mëposhtëm.

Studimi i interkstsutaliteti të romanin në fjalë, na jep mundësinë e njohjes me strukturat e veçanta tekstore me pafundësi kuptimore, semantikën evoluuese, me rrafshet e diskurse të shumëfishta që duke i'u referuar teorisë transaksionale: ku as dy lexues nuk mund të nxjerrin të njëjtin kuptim nga i njëjti tekst, bindemi për vetëdijen vizionare të autorit Mesha

⁶ Lexuesi model dhe lexuesi empirik – shprehje të Umberto Ekos, në veprën, *Gjashtë udhëtime në pyjet narrative*, (përktheu Bujar Hoxha), Asdreni, Shkup, 1997

Selimovië, për të krijuar një roman si esencë universale, që do t'u përgjigjet të gjitha kohërave dhe lexuesve. Aktual i fresket dhe i këndshëm për rilexim.

Në këtë kontekst mund të themi se ka studime cilësore, duke i'u referuar kësaj teorie, por duhet theksuar se studimet tekstologjike mbi romanin e tij janë të pjesshme ose të orientuara më shumë në elementet të gjuhës dhe stilit por shumë pak nga interteksti. Romani i tij, është prozë e vizionit mbi receptimin dhe frymëzimin poetik, raporteve interkomunikuese të semantikës dhe estetikës, të receptuesit dhe autorit përmes krijimit letrar, raporteve intuitive nëntekstore të cilat do të jenë pjesë e këtij studimi. Preokupimi i dekodifikimit të tekstin të tij, është një problem që vazhdon të ngacmojë kureshtjen e shumë studiuesve dhe kjo shton arsyet për të gjetur rrugën e komunikimit me të pathënën e tij të fshehur nëntekstin e tij poetik, njohjen e substratit të tij poetik dhe nxjerrjen e tharmit me të cilin autori ka ngjizur një roman unikat me një narracion tepër të fortë.

Remak konsideron se “terapia” për një dalje nga kriza mund të gjendet në atë se teksti mund të interpretohet në tërësi si “përmendore” letrare, por me kusht që njëkohësisht të studiohet në kuadër të proceseve historike të letërsisë. Kurse kjo duhet që të bëhet vetëm duke bërë krahasime me të tjerët.

Sipas TEORISË SË RECEPTIMIT nuk duhet që të ndalemi vetëm te shkrimtarët e mëdhenj dhe veprat madhore të ndonjë epoke, sepse përmbajtja e njëmendtë e një epoke mund të rikonstruktohet vetëm po qe se e kemi parasysh se çfarë kanë lexuar njerëzit dhe në çfarë mënyre e kanë pranuar (receptuar) atë që e kanë lexuar.

Në këtë mënyrë, shkenca e letërsisë, sërish inkuadrohet brenda mendimit historik. Dragan Jeremiq, gjykon se përderisa historia e studion vetëm të kaluarën, romani merret me kuptimin e jetës njerëzore në të gjithë dimensionet kohore. Derisa koha historike lëviz në një drejtim, në kohën romaneske ndodh që të vdekurit të flasin pranë të gjallëve, kurse *utopia dhe idealja të veprojnë në bashkëkohësi*⁷. Për dallim nga historia, romani nuk gjurmon pas fakteve të së kaluarës, as të vërtetës historike. Realiteti romanesk më shumë se sa realitet objektiv është gjendje e shpirtit, dramë e brendshme e heroit. Realiteti romanesk është i gjallë, i

⁷ Dragan Jeremiq: *Doba antiumjetnosti*, Kultura, Beograd, 1970, f.113

pakryer, i hapur për interpretime të reja nga kohë dhe hapësira të ndryshme. “*Dekori ndryshon, kurse drama njerëzore mbetet*”⁸

Për raportet e ngushta ndërmjet romanit, historisë dhe traditës flet edhe Roland Barthes, në “*Shkalla zero e shkrimit*”. Barthes mendon se historia dhe tradita vazhdimisht bëjnë trysni ndaj shkrimit, kurse ligjërimi asnjëherë nuk është i virgjër, sepse fjalët kanë një kujtesë të dytë⁹.

Këtë paradigmë e pasuroi edhe linguistika, e cila solli risi për sa i takon problemeve të stilit dhe metaforikës. E arritura më e madhe ishte se vepra u konsiderua si **TEKST**, prandaj duhej zbuluar ku qëndronte **KOHERENCA** e tij. Anglezët këtë shumësi e quajtën **CONNECTED SPEECH**, kurse francezët **DISCOURS**, ose në shqip **DISKURS = LIGJËRATË**. Të studiosh diskursin do të thotë të zbulosh mënyrën sipas së cilës krijohet kuptimi i një teksti. Duke menduar për tekstin u hap rruga për ndërlidhje të tjera, pra deri të **KONTEKSTI**. J. Lotman konsideron se çdo tekst formësohet nëpërmjet një organizimi të brendshëm. Duke u krijuar sipas një kuptimi arrin që të krijojë një sistem. Ky sistem, në diakroni dhe në sinkroni, shkon drejt sistemeve të tjera. P.sh. në sistemin e gjinive, lëvizjeve, në sistemin e letërsisë kombëtare, kurse më pas në sistemet shoqërore dhe kulturore. Hermeneutika konsideron se që një tekst të kuptohej më mirë nevojitej edhe psikanaliza. Rolan Bart zbuloi se te çdo shkrimtar ekziston një **ARKETIP** i heroit të tij.¹⁰

Post-strukturalistët francezë sikurse: Cvetan Todorov, Zhak Derrida, Zh. Lakan dhe Juli Kristeva i dhanë shumë rëndësi edhe psikanalizës së Frojdit. Ata konsiderojnë se nëpërmjet tekstit arrihet që të depërtohet në thellësi të shpirtit të autorit, kurse këtë mund ta bëjë psikanaliza. Duke u bazuar në këtë metodë, në vitin 1960, Zhan Pol Sartri shkroi biografinë e Gustaf Floberit, *L'idiot de la famille*. Rolan Barti përdori termin **ÉCRITURE**, që nënkuptonte se transformimi i mendimeve në shkronja nga ana e shkrimtarit ose poetit nuk ishte një proces mekanik, por një proces shumë i ndërlikuar. Brenda tekstit mund të ketë shumëçka nga jeta e autorit, madje pa pasur njohuri edhe autori për atë që është reflektuar në veprën e tij.

⁸ Nikolla Kovaç: *Romani politik evropian*, Gjurgja, Shkup, 2004, f.111.

⁹ Shih: Roland Barthes, *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008.

¹⁰ Salajdin Salih, *Letërsia e krahasuar*, Tetovë, 2016, f.27.

Në këtë drejtim, Juli Kristeva bën dallimin ndërmjet **GENOTEKSTIT** dhe **FENOTEKSTIT**. **Genoteksti** është teksti burimor që formohet në zonën materiale jo-gjuhësore të shenjave, që e ka burimin në pavetëdijen e shkrimtarit. **Fenoteksti** (teksti i fenomenit) formohet nga genoteksti dhe paraqet reflekset që shfaqen si shenja të para për të dëshmuar se vetëdija orientohet drejt një objekti. Pra, janë format e para të shenjave gjuhësore.

Në këtë drejtim mund t'i referohemi **Julia Kristevës** ose barsvlerësimit të përkthimit me një tekst tjetër, që, sipas Lotmanit, quhet **METATEKST**. **NEOTEKSTI** nënkupton tesktin e ri brenda tekstit. Kjo parashenjë është identitet letrar të Mesha Selimoviqit. Në rastin tonë ne do të përdorim terminologjinë intertekst.¹¹

Hipotezat

Gjatë studimit do të përdorim disa hipoteza të cilën në fund do të argumentohen ose mohohen:

1. Dervishi dhe vdekja, dervishi dhe drejtësia, dervishi dhe zoti
2. Si qëndron raporti i letërsisë dhe filozofisë?
3. Sa i saktë është interteksti kuranor, dhe sa ai sofist?
4. Personaliteti i dervishit, humbja e besimit, zhgënjimi tij, tundimi i tij, përballja me të vërtetët, a janë shënjes të një karakteri jo stabil të personazhit, apo thjesht rrethanat e caktuara e kanë shformësuar në këtë nivel?

Metodologjia e hulumtimit

Gjatë studimit do të përdorim metodën e intertekstualitetit, do ndalemi te citati, metataksti, qasja strukturaliste. Dimë se Intertekstualiteti si dije apo si metodë për

¹¹ Salajdin Salihi, *Letërsia e krahasuar*, Tetovë, 2016, f.25.

interpretimin e teksteve të shkrimit poetik në diskursin kritik është zhvilluar shumë vonë në fund të viteve të 60-ta dhe në fillim të viteve 70-ta të shekullit të kaluar së pari nga shkrimet e Julia Kristova, e më vonë edhe nga studiuesit e tjerë. Me intertekstualitet (intertekst) kuptojmë efektet e një teksti në tekste të tjera.

Çdo libër flet për librat e tjera, një libër lind (prodhohet) nga librat e tjerë, dhe çdo histori është histori e treguar njëherë, pra vetë libri i krijuar apo vetë historia e riprodhuar nga autori është intertekst. Intertekstualiteti si metodë për interpretim në tekstin kritik prodhohet në formën e citatit, lajmit, shënimit, retrospektivës, biograficizmit, historicizmit e të tjera, të cilat dëshmojnë vetëdijen e lartë kritike e estetike, dhe qasjen postmoderniste në ndërtimin e teksteve të saj.

Rëndësia e punimit

Mesha Selimoviç krijoi personazhe të shumtë, të cilët ndikuan në letërsinë artistike dhe në jetën e përditshme të shumë lexuesve. Personazhet e tij nuk mund të frymonin lirshëm në botën e tyre, por megjithatë ishin personazhe që karakterizoheshin me ëndrrat e tyre dhe mendimet pozitive për të ardhmen e afërt. Ishin personazhe që në çdo hap paragjykoeshin nga të tjerët por, kjo ishte edhe si rezultat i rrethit shoqëror dhe ndikimit të kulturave të huaja, të cilat tashmë atë e kishin pjesë të së përditshmes dhe bota i njihte me anë të tyre. Personazhet e tij ishin luftëtarët e jetës që nga mëngjesi i hershëm e deri në natën e vonshme, kur armiku kishte mundësinë më të madhe të vepronte dhe të realizonte qëllimet e tij, kundër një populli të shtypur dhe që vazhdimisht mendohej të ishte nënshtrues i tyre edhe për një periudhë të caktuar kohore. Personazhet e tij harronin të gjitha gjërat tjera, por nuk harronin të drejtën që u përkiste atyre dhe dashurinë që armiku mendohej t'ua largonte e t'i bënte qenie pa vetëdije dhe pa një mbështetje, të cilën mund t'ua jepte vetëm familja dhe vëllai, siç e kemi në këtë rast me romanin në fjalë të autorit Selimoviç.

KREU I

I.1 LETËRSIA DHE FILOZOFIA, RAPORTI I LETËRSISË ME BEKTASHIZMIN DHE SUFIZMIN

Sufizmi në mënyrë të përgjithshme nga dijetarët kuptohet si dimension i brendshëm apo mistik i Islamit. Një predikues i kësaj tradite zakonisht njihet si sufi. Përderisa të gjithë myslimanët besojnë se janë në udhëtim për te zoti dhe do të jenë afër zotit në parajsë- pas vdekjes dhe pas ditës së gjykimit, sufinjtë besojnë gjithashtu se është e mundur që njeriu të afrohet afër zotit dhe ta përjetojë afërsinë e tij përderisa është gjallë. Pra, *“të vdesë para se të vdesë”*.¹²

Shejhu Ahmed Zerruk (shek.XV) shkroi në librin e tij “Principet e sufizmit” se:- *“Sufizmi është rregullim i zemrës dhe tërheqja e saj nga çdo gjë tjetër, përveç zotit”*. Shejhu Ahmed Ibn¹³ Egjiba, një sufi maroken i famshëm e definoi sufizmin si:- *“Shkencë nëpërmjet së cilës njeriu mund ta kuptojë si të udhëtojë në prezencën e hyjnore, ta pastrojë veten e brendshme nga ndrytësitat dhe ta zbukurojë atë me virtyte të ndryshme lavdërimi”*.

Sipas teorisë së sufizmit, njeriu në gjendjen e vet normale është një pjesë shtazë dhe një pjesë njeri, pra është jo i kompletuar. Sipas sufizmit, Islami na mëson se besimtarët e sinqertë nga të gjitha fetë, në fakt përbëjnë një komunitet të vetëm prej njerëzve të drejtë dhe Allahu ua jep atyre bekimin e plotë.

Sufizmi përfaqëson aspektin e brendshëm të islamit dhe se doktrina e sufizmit në thelb është interpretim me zemër i Kuranit. Qëllimi kryesor i sufinjëve është të lirohen nga të gjitha nocionet e kualitetit, duke përfshirë edhe konceptin e vetvetes individuale dhe ta realizojnë unitetin hyjnor. Këtë e arrijnë nëpërmjet meditimit, kujtimit të zotit apo që quhet ndryshe edhe

¹² Ali Tyrabiu: Historia e bektashinjve, Tiranë, 1929, fq. 65, cituar sipas, Memli Krasniqi: Shoqëria biblike britanike për të huajt dhe bektashizmi (1814 - 1897), Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2013, fq. 94

¹³ Ibn(arab.)- do të thotë i biri

dhikër. Dhikri si një akt i devotshëm realizohet nëpërmjet hadrave¹⁴ në zavije¹⁵ dhe përfshin përsëritjen e emrave hyjnorë, lutjeve dhe aforizmave nga literatura e hadithit dhe Kuranit¹⁶. Në dhikrin e tyre ata përdorin hunë¹⁷ dhe semajën¹⁸.

Tani jetojmë në një kulturë, e cila është përshkruar si materialiste, vetjake, individuale, narcisiste dhe e dergjur me siklet, turp dhe faj. Nga pikëpamja sufiste njerëzimi sot vuan nën tiraninë më të madhe që është njohur ndonjëherë, tiraninë e egos. Ilaçi themelor i egoizmit, materializmit dhe pavetëdijësisimit është ideja e prezencës me dashuri.

Me vetet tona falso, ne duke ia kthyer shpinën zotit kemi humbur esencën e vetes sonë, shkëndijën tonë hyjnore. Me harresën e zotit ne kemi harruar vetveten. Të kujtosh zotin është fillimi i kujtimit të vetvetes.

Degët sufiste janë :

1. Bektashizmi
2. Qishti
3. Mevleviu
4. Rifaija
5. Shatari
6. Nimatullahi
7. Tijanijehi

Bektashizmi si degë sufiste theksin e vë në thelbin a kuptimin e brendshëm e jo në respektimin e konvecioneve të jashtme. Bekatshinjtë falen dy herë në ditë dhe faljen nuk e bëjnë detyrimisht me fytyrë të kthyer nga Meka. Kur falen nuk përkulen detyrimisht në gjunjë. Nuk e hanë mishin e dërrit, nuk i prekin breshkat, qentë e gjarpërinjtë me dorë, dhe mbi të

¹⁴ Hadra-grumbullimet që bëjnë sufinjtë kur e lavdërojnë profetin

¹⁵ Zavije-faltoret që i përdorin sufinjtë për veçim si shkak adhurimi dhe ushtrimi të ibadetit

¹⁶ ëëë.formishqiptar.com/threads/94861-çfarë-është-sufizmi

¹⁷ Hu-përemri i vetës së tretë të numrit njëjës-ai, me këtë kanë për qëllim Allahun e lartësuar

¹⁸ Semaja-term për këndimin e dhikrit, poezive dhe lavdërimet profetike me melodi apo me vegla muzikore

gjitha nuk u afrohen lepujve. Për dallim nga myslimanët e tjerë ata e pijnë alkoolin dhe atë e përgatisin vet në teqe¹⁹.

I.2 BOTA EKZISTENCIALE DHE METAFIZIKE

Ahmed Nurudin jeton në dy botë: metafizike dhe ekzistenciale. Bota metafizike është e gjerë, mbizotëruese dhe vendimtare. Nuredini u rrëzua në të pas një humbjeje, shumë i dobët dhe i paditur për t'u marrë me jetën. Bota metafizike ka kapur tërë Nuredinin, duke e zotëruar atë dhe në shumë aspekte duke përcaktuar lidhjen e saj me jetën. Metafizikisht, ai e shtyn atë në humnerën e thellë të mendimit dhe të rimenduar, zotëruar vullnetet dhe veprimet, administron jetën. Në botën e të jetuarit metafizik, ai vetëm herë pas here dhe me siguri del prej saj, nga frika se nuk do të dëmtojë mësimin dhe nuk gabon në dogma. Ai është i paaftë ta përcaktojë veten ndryshe nga sa e ka zotëruar. Kjo është arsyeja pse bota ekzistenciale është e parëndësishme dhe e ngërçuar, e panjohur dhe e huaj. Nuredin është thjesht duke e shikuar atë me ankth dhe një ndjenjë të pasigurisë, të mbingarkuar me shqetësim dhe frikë se mos gaboni, të bëni një lëvizje të nxituar, të mos e turpërojnë thirrjen dhe pozicionin e tij.

Ai nuk e di sa duhet për botën e jetës sepse u tërhoq nga ajo herët dhe u mbyll në mësim dhe dogmë, është injorant dhe i paaftë ta ndjekë atë. Kjo është arsyeja pse si i tillë - i panjohur, kërcënues dhe shqetësues - ai është i huaj dhe i largët, kështu që ai nuk përpiqet ta takojë apo ta shijojë. Kjo botë rrotullohet rreth tij me gjithçka që mbart dhe Nuredini nuk e di se çfarë po ndodh në të. Në këtë botë, Nuredini është një i huaj dhe i huaj: ai nuk mund ta dëgjojë, perceptojë dhe ndiejë atë; shqisat e tij u injoruan, ndjenjat e tij ishin zhdukur, dëshira e tij u dobësua. Kërkohet një tërmet, telashe apo fatkeqësi e fortë, në mënyrë që Nuredini të endet, të interesohet për një botë përtej teqes dhe besimit, dhe pastaj ai do të kuptojë se sa larg dhe i huaj është ajo botë dhe sa injorant është ai. Kjo do të marrë hak ndaj tij, sepse rebelimi dhe hakmarrja që vijon do të përmbushen pjesërisht, por ai vetë do të vuajë për shkak të paaftësisë së tij për të menaxhuar dhe mbajtur veten në botën ekzistenciale. Dalja në botë dhe përpjekja

¹⁹ Teqe-vendi ku jetojnë dhe rijnë dervishët gjatë gjithë kohës

për ta trajtuar atë do ta sjellë Ahmed Nuredinin në humbjen e tij. Besimi, mësimi dhe dogma formojnë botën metafizike të Ahmed Nuredinit. Në arratisjen e tij nga jeta, pas një humbjeje të pashpresë, të cilës as nuk mund t'i rezistonte, ai gjeti strehë në besim. Ai iu përkushtua mësimi të Kuranit, plotësisht i zhytur në të, e pranoi atë si rregull që qëndron mbi jetën.

Personaliteti i shtypur: *“Unë kam qenë një dervish për njëzet vjet dhe kam shkuar në shkollë si fëmijë i vogël, dhe nuk di asgjë përtej asaj që ata donin të më mësonin. Ata më mësuara të dëgjoja, të vuaj, të jetoja për besimin. Kishte më mirë se unë, nuk mendoj shumë. Unë gjithmonë dija se çfarë të bëja, rendi dervish mendonte për mua, dhe themelet e besimit ishin të vështira dhe të gjera, dhe asgjë nga imja nuk ekzistonte që nuk mund të futej në to.”*²⁰

Për Nuredinin²¹, "besimi është më i rëndësishëm se njeriu" dhe "Vullneti i Zotit është ligji suprem", kështu që ai do të shkojë larg nga bota dhe njeriu, duke u mbyllur në një botë dervish të ndërtuar mbi pasazhet e mësuara të Kuranit, të cilat shërbejnë si një koment për të gjitha ato shfaqen ose zbulojnë jashtë kësaj bote. Vendet e Kuranit janë gjithashtu përmbajtje e të gjithë bisedës: nuk flitet sipas diktateve të arsyes ose qëndrimit të vetvetes, por citatat e mësuara në orët e gjata të vigjilencës mbi doktrinën e besimit dhe urdhërit dervish janë më të ulëta. Besimi bëhet një strehë e dyfishtë: për pasivitet dhe për veprim. Nuredini do të justifikojë tërheqjen e tij nga bota ekzistenciale, ndërhyrje në atë që po ndodh në atë botë, dhe pasivitet që shkon në mbyllje totale, me anë të besimit që nuk lejon asnjë dalje në një botë të jetës së përditshme, në të cilën joshin tundimet dhe shkeljet. Ka ngjarje fatale që ndodhin rreth Nuredinit - vëllai i tij arrestohet dhe burgoset në fortesë, dhe ai nuk di asgjë për këtë. Dhe kur e zbulon, ai reagon me vakum, me kujdes, frikësohet për veten e tij dhe e kundërshton vëllain e tij për rrezikimin e tij. Dhe kur ka një rebelim në të, i irrituar nga urrejtja dhe dëshira për hakmarrje, atëherë Nuredini do të fshihet pas besimit dhe do të justifikojë rebelimin e tij duke luftuar armiq të besimit.

Për këto arsye, Nuredini vetëm pjesërisht përmbledh jetën ekzistenciale; ai i shfaqet atij vetëm në skica të paqarta, kryesisht në ato pamje të mbetura nga fëmijëria e hershme apo rinia. Bota e dashurisë, besimit dhe jetës vetëm herë pas here rrethon Nuredinin dhe më pas, nga frika se mos i nënshtrohet tundimit, tërhiqet shpejt në botën metafizike si strehë dhe

²⁰ Mesha Selimović, (2008), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, T iranë, f.10.

²¹ Po aty, f. 15.

mbrojtje. Jeta ndodh në ato kujtime sporadike të fëmijërisë dhe rinisë, në të cilat kishte ngrohtësi dhe dashuri. Në pragun e jetës, Nuredini i mungoi dashuria- vajza, e martuar një ditë para kthimit të tij nga lufta, dëshiron të arratiset me të sepse ende e do atë, por Nuredini nuk e ka guxim dhe vullnetin ta pranojë aktin, të tërhiqet i mposhtur dhe të largohet nga atdheu i tij për të gjitha kohërat. Në besim ai gjen ngushëllim për shpirtin e tij të plagosur. Megjithatë, Nuredini ndjen nevojën për dashuri, e kërkon atë, bëhet nevoja dhe mbështetja e tij. Ai e gjen atë mbështetje në miqësi me Hasanin.

Nuredini është kërcënuar njerëzisht dhe vetëm herë pas here copëtohet, shkurtimisht, të tërhiqet shpejt, nga frika se mos e shkundë rregullin e vendosur të mendimit dhe sjelljes. Nuredini është i vetëdijshëm se është i paafte për të dashur, nuk është në gjendje të jetë i butë, kështu që momenti kur shfaqet "butësia e vonuar" tek ai është vetëm shërimi i plagëve të tepërta të së kaluarës. Marrëdhënia e tij me vëllain e tij është interesante në ato momente kur mëson për arrestimin e tij. Lajmi e godet në një mënyrë të papritur: arrestimi i errësoi paqen dervishit të Nuredinit, e vuri në rrezik, e vuri në dilemë se çfarë të bënte dhe si të vepronte. Për shkak se frika nga fuqia mbretëron në të, e maskuar por gjithçka më e fuqishme, Nuredini ka hezituuar të vendosë: të heshtë dhe të qëndrojë i qetë ose të bëjë diçka.

“Do të ishte e shëmtuar të qëndroja larg, dikush do të më fajësonte mua. Nuk harrova se çfarë kisha menduar më parë, të frikësohesha për veten time dhe të ndjehesha keq për të, as nuk dija se çfarë ishte më e rëndësishme, as nuk u ndava lehtësisht nga njëri-tjetri”²².

Ai ndërmerr disa hapa jo sepse dëshiron apo ndjen nevojën, por sepse është i detyruar: babai i tij pret që ai të ndihmojë vëllanë e tij (nga njëra anë), dhe ai vetë e di se çfarë do të thonë njerëzit nëse nuk bën asgjë (nga ana tjetër). Me ngurrim ai lëviz muselima, pret që ai të mos gjendet në shtëpi ose se nuk do ta marrë. Ai është gjithashtu i shqetësuar nëse autoritetet do të marrin interesin e tij për vëllain si një veprim i kundërshtimit të tij, dhe nëse kjo do të rrezikojë paqen dhe sigurinë e tij. Ajo kalon orë të gjata duke menduar dhe vetëkzaminuar, duke peshuar arsye dhe justifikime. Për shkak të ngadalësisë dhe hezitimit për të reaguuar shpejt dhe kërkimit të kotë të ndihmës nga autoritetet mizore, Nuredini ndihet fajtor kur

²² Mesha Selimović, (2008), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, Tiranë, f.11.

mëson se vëllai i tij u vra në fortesë. Edhe atëherë, Nuredini nuk reagon siç pritej. Në fillim, lajmi nuk e godet atë, ai nuk vajtohet për fatin e pafat të Harunit. Kur lind urrejtja dhe lind dëshira për hakmarrje, Nuredini nuk ka guxim të rebelohet. Në ato momente, ai është një njeri i dobët, i mbërthyer nga besimi dhe frika nga pushteti. Por kjo dobësi është gjithashtu rezultat i tjetërsimit të tij nga bota dhe jeta, pasojë e injorancës së marrëdhënieve në shoqëri dhe thelbi i moralit, drejtësisë dhe rendit.

Nuredini është një personalitet introvert; ai është drejtuar vetvetes dhe botës së tij, i mbyllur për veten e tij dhe i padepërtueshëm, është e pamundur të njohësh gjendjen e vërtetë të shpirtit dhe vullnetit të tij. Ky tipar e bëri atë mosbesues dhe të dëbuar nga njerëzit:

“Kam mësuar të fshihem nga të tjerët.

Jam mësuar të dëgjoj, të mos ankojem, të përkul kokën. Unë kam qenë vetëm, deri tani. Dhe isha i kënaqur.

Ju jeni një njeri i çuditshëm. Ju flisni pak, ju fshihni (...) Ju fshiheni pas fjalëve. Unë nuk shoh se çfarë është brenda jush.”²³

Tjetërsimi nga njerëzit e bën atë të tjetërsuar nga bota dhe jeta. Bota përtej teknologjisë dhe besimit nuk është nga masa dhe vullneti i Nuredinit, kështu që ai kërkon të heqë veten nga ajo, shpesh duke ikur në irracional, meditimin dhe regresionin (kthimin mbrapa). Herë pas here do të ketë një mundësi për të përqafuar jetën, për t’iu qasur botës përtej teqesë, te njerëzit:

Doja të kthehesha te impersonalja. Unë u kam zili të gjithëve këtë mëngjes sepse mëngjesi i tyre është i përditshëm.

“Do të ishte mirë sikur të isha mashtrues. Ai gjithmonë mund të kërkojë njerëz të mirë dhe vende të dashur, dhe të mbajë një shpirt të gëzuar për qiell të gjërë dhe një rrugë të lirë që të çon askund, që të çon kudo. Nëse vetëm një njeri nuk do të mbante vendin që fitoi”²⁴.

Sidoqoftë, ai largohet nga kjo mundësi, duke pasur frikë se mos dëshira e tij nuk e mposht atë, se ai nuk heq dorë dhe nuk shkel parimet e tij, dhe heq dorë nga zakoni i të jetuarit në peripecitë dhe heshtjen e meditimit dhe të mësuarit. Dita e Lily e luginës - me jetën e saj të egër, sensualitetin dhe dinamizmin - magjeps Nuredinin, zgjon shqisat e tij, ringjall kujtimet, por në të njëjtën kohë ekziston edhe dënimi i asaj pompimi dhe relaksi festiv. Ai është i

²³ Mesha Selimović, (2008), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, Tiranë, .f.19

²⁴ Po aty, f. 25.

pëshirë dhe tërhiqet të mos e dëgjojë dhe ta ndiejë atë jetë të nxehtë. Në momente të rralla, dëshira për jetën shfaqet në formën e një dëshire për mashtrim, në formën e kujtimeve të fëmijërisë ose në formën e dëgjimit të gëzueshëm të jetës së natyrës. Një dëshirë e fortë për jetën do të shfaqet vetëm në fund, pas humbjes përfundimtare, kur ai tashmë po mendon për fundin e tij fizik. Në ato momente, kujtesa për gjithçka u rinovua dhe fryma e jetës që kaloi u ndje përsëri. Por kjo është e gjitha. Keqkuptimi është kuptuar plotësisht në atë moment.

Nuredini i afrohet botës ekzistenciale vetëm kur lind urrejtja. Atëherë ai ndjen se duhet të veprojë në atë botë, që ai nuk mund të shpëtojë më nga ajo dhe të strehojë në botën e tij të tekhit. Torturat që rrodhën nga arrestimi dhe vrasja e Harunit, torturat që rridhnin nga pavendosmëria dhe pasiguria e Nuredinit, por edhe për shkak të mungesës së orientimit të tij emocional, e bënë atë një njeri të papërcaktuar "*i cili nuk është as i shëndetshëm dhe as i sëmurë*":

*"Nga kjo gjendje torturuese, urrejtja më nxori jashtë. Më ringjall dhe më vendosi, duke u ndezur një ditë, në një çast, si një flakë. Tani e forcova, duke e mbajtur para meje si mburojë, si armë, si zjarr, të dehur me të, si me dashuri."*²⁵

Ndërsa më parë zemra kërkonte mbështetje në dashuri, tani ajo gjeti mbështetje në urrejtje dhe jeta morri kuptimin e saj. Tek Nuredini, shfaqet një ndjenjë e pasurisë së brendshme, lëshohet frika nga pakuptimësia e jetës, fillon të shfaqet rendi i dëshiruar. Urrëjtja është shumë e fortë: Nëse urrejtja kishte erë, do të ndjehej si gjak pas meje. Nëse do të kishte ngjyrë, gjurmët e zeza do të ishin pas thembrave të mia. Nëse ai mund të fliste, flakët do të fryheshin nga të gjitha hapjet e mia. E vetmuar mes varreve, harrova urrejtjen. Ajo u kthye tek unë kur iu afrova njerëzve.

Nga urrejtja, lind një dëshirë për hakmarrje. Tani është preokupimi kryesor i mendimeve të Nuredinit. Ai bëhet intrigues racional dhe i rrezikshëm, duke thurur dinakëri. Tani autoritetet po e tregojnë veten në një dritë tjetër. Nuredini i frikësohej pushtetit, frika nga pushteti e frenoi atë, duke bllokuar veprimin e tij. I kapluar nga urrejtja dhe i nxitur nga dëshira për hakmarrje, ai e kupton se pushteti është një mjet i shkëlqyeshëm për të ndjekur

²⁵ Mesha Selimović, (2008), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, Tiranë, f.19.

hakmarrjen. Kjo është arsyeja pse ai shqetësohet nga posedimi i pushtetit dhe fuqisë së dikujt tjetër:

Po kështu, Nurudin refuzon konvertimin në Hasanizëm që i është ofruar: ai do të preferonte të bëhej kadi dhe të provonte përsëri me rregull, qartësi, sistem dhe mendim aksiomatik, të gjitha bazuar në një besim që ai e ka humbur një herë, dhe të cilin nuk do ta bëjë në atë përpjekje të përsëritur, arrijnë të mbajnë.

Prandaj, nuk ka asnjë zbulim që mundëson kalimin nga një formë negative në një formë pozitive të jetës në zhanrin rrëfyes. Nga të gjitha ato rrëfime, tradicionale ose moderne, Nurudini ruan vetëm këtë: pa Zotin, pa ndjekës, pa zbulesë, pa shndërrim në pozitiv, Ahmed Nurudini vazhdon të rrëfejë dhe rrëfimi i tij drejtohet drejt vdekjes.

Në fund, vetëm ato dy gjëra kanë mbetur në romanin "Dervish dhe vdekja": rrëfimi i rrëfyer dhe vdekja.⁶⁰

⁵⁹ Zoran Milutinović, *Šta je derviš ispovedio o smrti: Derviš i smrt Meše Selimovića* (Zdenko Lešić i Juraj Martinović [ur]: Književno djelo Meše Selimovića, Sarajevo: Akademija nauka i umjetnosti Bosne i hercegovine, 2010, str. 54

⁶⁰ Po aty, f. 55

III.2 3D-JA E NJË PERSONAZHI

Ahmed Nurudin humb besimin në zot dhe në drejtësinë e shtetit ligjor në momentin kur punët e tij nisën të shkojnë keq dhe vëllai i tij burgoset, ndërsa tentimet e tij për ta shpëtuar atë dhe për ta kuptuar arsyen se përse është burgosur.

Ai ka të drejtë të di arsyen, pshenë e burgosjes dhe në një shtet ku ka ligje në emër të të cilave dënohet duhet medoemos të ketë dhe arsyen, kohën e dënimit, vendin e burgosjen, kushtet e burgut... Ai nuk arriti ta shpëtojë vëllain e tij nga burgosja dhe në fund rezultojë i vdekur, ai humbi besimin në zot dhe drejtësinë e shtetit. Ashtu i zhgënjyer i rikthehet punëve të lëna pas dore dhe behët kadi.

Ka një pjesë mjaftë të bukur, edhe atë në fund të romanit përsëri e humb besimin por kjo luhatje e fundit në aspekt të besimit në shtet dhe në zot, në drejtësi dhe në fe, qenë aq ekstreme, dhe vënë në pah një personalitet tjetër fare të Nurudinit, veprimet e tij janë efekt i gjendjes së tij psikologjike dhe ndryshimeve të bindjeve të tij për shtetin, për zotin, për drejtësinë dhe fenë.

Ky është edhe elementi kryesor strukturor i veprës „Dervishi dhe vdekja“... Rrëfimi i Nurudinit fillon dhe mbaron me mosbesimin e tij në zot dhe në rendin metafizik dhe etik dervishjan. Këtu autori krijon aluzionin se shpesh njerëzit që veshin petkun e prifterisë, hoxhës apo dervishit në fund dalin si njerëz që nuk kanë besim, si njerëz që fshihen prapa atij petku për ndonjë qëllim tjetër. Vetë aluzioni është marker i intertekstualitetit Gjatë kohës kur ai ishte kadi për një periudhë i rikthehet besimi në zot, por këtë besim mund ta quajmë edhe dyshim i cili shpesh paraqitet edhe te besimtarët (krizë momentale religjioze), dhe në fund Nurudini si personazhi që bartë në supet e veta gjithë ngjarjen vdes pa besimin në zot dhe me zhgënjim në drejtësinë e shtetit.

Titulli i romanit, megjithatë, nuk është "Dervishi dhe Drejtësia" as "Dervishi dhe Perëndia", por „Dervishi dhe Vdekja“. Të dyja, drejtësia dhe Perëndia janë të rëndësishme si makro tema brenda veprës por në lidhje me vdekjen ato kanë rëndësi dytësore. Çfarë është kjo vdekje, vdekje dervishit? Përkundër të dhënave historike të cilën renditëm mirë brenda romanit të Selimoviçit, vdekja është një vdekje tjetër, një vdekje, vdekja e një nihilisti. Kush është nihilisti? Kur, pas humbjes së besimit, personazhi bartës i veprimit, Nurudini për vdekjen, thotë: "Dhe pastaj asgjë nuk ndodh, asgjë nuk ka. Nuk ka takim me krijuesin, i cili nuk ekziston, as shpërblime, e as ndëshkime. Dhe kur afërsia e vdekjes bëhet e vërtetë, Nurudini e refuzon atë me tmerr: "Jo, në asnjë mënyrë! Çfarëdo që të ndodhë, unë dua të jetoj, në një këmbë deri në vdekje, në një shkëmb deri në vdekje, por dua të jetoj! ". Dhe në fund të fundit, kur nuk përpiqet të mobilizojë forcën e tij të jetës për rezistencë ndaj vdekjes, ai shkruan shumë fjalë të cituara: "Sepse vdekja ka qenë e pakuptimtë, si jeta" .

Duket e pazakontë që dikush që erdhi në këtë konkluzion e ndjen nevojën për ta shkruar atë. Nëse jeta dhe vdekja janë të pakuptimta, atëherë nuk ka shumë arsye për të shtuar një fjali tjetër në absurditetin e përgjithshëm. Në kuptimin e përgjithshëm të jetës dhe të asaj që vjen pas saj, është më e lehtë, më logjike dhe konsistente që të përmbahet nga ai shënim, por ai e shkroi në afekt, në gjendje të rëndë psikologjike, në trans, në depresion. Nurudini nuk ngurron sepse kjo fjali është pika përfundimtare e rrugës së tij të jetës, gjëja e fundit të cilën ai e kuptoi nga jeta. Ai kupton se nuk ishte në dijeni kur e rrëfeu historinë e tij personale, rrëfeu si një para pasqyrës, rrëfeu si Rusoi, si Agustini, si Podrimja letrës së bardhë... Është dhimbje të rrëfeshesh dhe po aq dhimbje zhgënjimi se kujt i rrëfeshesh. Pas leximit të romanit dhe thënë më mirë leximit të kujdesshëm të romanit, vijmë në po këtë përfundime.

Dhe kur e vendos atë në letër, lë plotësisht lapsin dhe nuk shkruan më. Jo vetëm që pas asaj fjale nuk ka me fjalë, por edhe gjithçka që i parapriu kësaj fjale i duket mjaft e panevojshme dhe e pakuptimtë.

III.3 PERSE DHE KUJT I RRËFEHET NURUDINI?

Kjo pyetje është e vështirë të përgjigjet pa iu kthyer traditës së zhanrit rrëfimtar dhe transformimet e tij në epokën moderne. Sigurisht shembulli më i njohur i këtij zhanri janë „Rrëfimet“ e Augustinit. Augustini i drejtohet Perëndisë, e lavdëron atë dhe bën rrëfimin e mëkatit. Në nëntë librat e parë Augustini përshkruan shpirtrat që enden pa strehimin e Perëndisë, dhe në katër librat tjera fut jetën e tij njerëzore dhe pastaj të të gjithë botës. Rrëfimi është kryesisht një shënim i kthimit dhe pendimit: Augustini rrëfihet për mashtrimet tokësore, injorancën ose mungesën e njohjes e së vërtetës së botës. Kuptimi moral i tekstit është i bazuar në integrimin e konvertimit dhe vdekjes. Rrëfimi është i mundur në sajë të besimit të Augustinit në idenë e hyjnisë: ai ia jep zotit jetën e tij duke thënë se Zoti din më mirë se çka të bëjë me atë që i takon, pra e kupton që gjithçka në këtë botë, madje edhe jeta e tij janë pronë e Perëndisë. Për këtë akt ai pret edhe një përfitim: strehim i përjetshëm me kushte të mira jetësore. Ai i bën rrëfimet në mënyrë publike me qëllim që edhe të tjerët ta ndjekin shembullin e tij, sepse rruga e tij jetësore paraqet kalimin nga e keqja në të mirë, dhe për shkak se transformimi i tij është nga negativja në pozitiv.

Kemi edhe një shembull tjetër të rrëfimeve: Rusoi në Rrëfimet e tij shpreh idenë se në ditën e gjykimit ai do të qëndroje para gjyqtarit suprem me librin e tij, me veprat të cilat i ka bërë, me gabimet dhe përmirësimet, duke shpresuar se përkundër gabimeve gjyqtari suprem do ta kuptojë se Rusoi është më i miri ndër të gjithë të tjerët. Njësoj si Augustini, edhe Rusoi në një moment kupton se përse është krijuar njeriu dhe cili është roli i tij në natyrë, por ky zbulim për Rusoin do të jetë hapi i parë nga pafajësia, qetësia dhe paqja për në mëkat dhe luftë me të tjerët.

Të dy rrëfimet janë ekzemplar të kundërt: rrëfimi i Augustinit tregon për një njeri jeta e të cilit kalon nga mëkati në kthim në fe duke e bërë atë hero pozitiv, ndërsa rrëfimi i Rusoi na çon nga pafajësia deri në luftë, duke mos e humbur besimin primar e veprës që ai gjithsesi është i pafajshëm ndërsa vetë jeta është fajtores për veprat e tij, dhe Perëndia në ditën e gjykimit do ta njoh këtë.

Strukturën e njëjtë e përsërit edhe rrëfimi i heroit të Albert Kamy - Merso nga romani “I huaji”. I huaji është rrëfim fiksional i heroit zotëri Merso. Rrëfimi i tij bëhet me tensionues në pjesën e tretë kur e ndjen afërsinë e vdekjes, por nuk përbëhet nga afrimi me zotin pasi vet ai është fetarisht indiferent dhe thotë se zoti nuk ekziston, por nga vetëdijesimi se drejtësia nuk ekziston. Mosbesimin e tij në zot e shohim në momentin kur ai takohet me priftin dhe para tij hapen dy rruga: rruga e shpëtimit ose e mallkimit. E shohim tezën se kjo botë shërben vetëm që të përfitohet bota tjetër, dhe nëse punohet për shpëtimin tënd në botën tjetër jeta jote ka vlerë, e nëse punohet për humbjen tënde jeta e humb vlerën e saj. Merso nuk e beson këtë, dhe madje as nuk ndihet fajtor për krimin për të cilin fajësohet, prandaj për të jeta është aq e vlefshme sa edhe e pavlefshme.

Kur ballafaqohet me idenë e vdekjes ai nuk shpreh ndjenja te qarta, nga njëra anë thotë se jeta nuk ka vlerë, por nga ana tjetër mendon për atë se si do t’i jetonte 20 vitet e ardhshme nëse nuk do të ishte i dënuar me vdekje. Ai nuk beson në zot, nuk beson se rrëfimi i tij do t’i sjell ndonjë të mirë, prandaj e refuzon ofertën e priftit duke e shprehur idenë se njeriu nuk duhet të jetojë me mirë, por me shumë, dhe nëse nuk ekziston fuqia hyjnore e cila e kontrollon botën atëherë vetë njeriu është zoti i vetvetes. I çliruar nga frika dhe shpresa Merso shpreson se me vrasjen e tij edhe populli do ta kuptojë zbulimin e tij të fundit, prandaj shpresonte se në ditën e vrasjes atë do ta përcjellin sa më shumë njerëz, të cilët do ta shprehin urrejtjen e tyre ndaj tij, njëjtë siç e shprehen ndaj Jezu Krishtit, i cili në fund e arriti qëllimin e tij të fundit dhe e vërteta e tij fitoi. Por, është paradoksale që nëpërmjet shembullit të Krishtit, ai don ta thejë ideologjinë e Krishtit.

Por, le te kthehemi te romani Dervishi dhe vdekja. Romani ka formën e dorëshkrimit të gjetur, më saktë – të rrëfimeve të gjetura. Për ta bërë atë produktiv, është e nevojshme që në rrëfimet e Nurudinit të gjinden linjat themelore të këtij zhanri dhe te shqyrtohet se çfarë u ndodhi atyre. Prandaj, rrëfimi duhet të përmbajë një fjalim drejtuar Perëndisë me arsyetimin e jetës së vetë dhe t’u drejtohet pasuesve me rekomandimin që edhe ata të ndjekin këtë rrugë jetësore. Gjithashtu, në rrëfim, duhet të gjesh momentin e shpalljes, të botimit të njohurisë së vërtetë tek ata që pranohen. Dhe, më e rëndësishmja, kjo zbulim duhet të drejtohet kah vdekja.

Ahmed Nurudin fillon solemnisht rrëfimin e tij, duke e njoftuar lexuesin për rrëfimin mbi vetveten, për „bisedën“e shënuar me vetveten, për të gjetur një zgjidhje për problemin dhe për ta parë veten se si është, si do të bëhet e do të ndryshohet duke u çuditur se përse nuk ka qenë i tillë gjithë jetën. Fillimi i rrëfimit të tij duket se qëndron pas momentit të konvertimit - më saktësisht, de-konvertimit sepse Ahmed Nurudini shfaqet si një besimtar që kalon në jobesimtar. Në një moment, duket sikur gjeti paqen me besimin nga, i cili ishte distancuar dhe mendohet se si mund të ketë dyshuar ndonjëherë, por ky moment nuk zgjat shumë dhe nuk sjell ndonjë ndryshim: është vetëm një përpjekje e dështuar dhe Nurudini përfundon rrëfimin e tij ne gjendjen e njëjtë në të cilën edhe e fillon atë.

Ekziston edhe një mundësi tjetër për të kuptuar Ahmed Nurudin. Besimi dhe mosbesimi janë rrënjësisht të ndryshme: ndërkohë që besimi e njofton njeriun me kuptimin e botës, vendin e tij në të dhe qëndrimin e tij ndaj vdekjes, mosbesimi e largon nga ajo, duke mos ofruar asgjë për këmbim. Në fillim të romanit, Ahmed Nurudin e kishte humbur veten dhe ende duhet të forcohej kuptimi i ri për vetveten, botën dhe vdekjen. Ai po kërkon zbulimin e tij. Gjatë rrëfimit të tij përsëriten shenja se Nurudini mund të gjente pasazhin nga negativ, të cilin ai e refuzoi, përmes pavlefshmërisë në të cilën ishte, për një kuptim pozitiv të vetes dhe të botës, duke pranuar vdekjen që do të pasonte. Ky pasazh duket se i ofron ose ia afron shoku i tij Hasani, i cili me siguri e dinte të fshehtë për të cilën Nurudini gjurmonte aq shumë.

Nurudini beson se kjo botë do të ishte një vend më i mirë për jetesë nëse do të mbisundonte rendi i rreptë, duke thënë se ky rend duhet të jetë i pranuar dhe i kuptueshëm për popullin, ndërsa ato të cilët jetojnë në rrëmuje dhe kaos jetojnë në një botë të rrejshme dhe jo të kuptuar. Por, për Hasanin është më e pranueshme që njeriu t'i ketë horizontet e tij jetësore pa një sistem të mbyllur tërësisht. Kjo ide e Hasanit nga njëra anë e tërheq Nurudin por nga ana tjetër edhe e largon prej tij, pasi sipas Nurudinit, Hasani për asgjë nuk është i sigurt dhe nuk kërkon asnjë mbështetje.

Në këtë pikë do të ishte e lehtë dhe e thjeshtë, të vazhdohet në drejtim të nihilizmit të Niçes ku do të flitej për ankthin e Nurudinit për shkak se ai kalon në një nihilizëm pasiv, ndërsa Hasani do të paraqitej si një nihilist aktiv. Por në veprën “Dervishi dhe vdekja”, Hasani

paraqitet jo si nihilist, por si një njeri, i cili nga mospërputhja dhe jostabiliteti krijon horizontin e tij kuptimplotë. Mospërputhja në këtë kontekst duhet të kuptohet si kundërvënie ndaj kërkesës së Nurudinit për një rend metafizik, aksiologjik dhe etik. Në veprën *Dervishi dhe vdekja* M.Selimoviçi i paraqet njerëzit si qenie kontradiktore. Hasani, një burim i tolerancës, është shumë më fleksibil për jetën dhe njerëzit. Ndërsa, Nurudini është fanatik i rendit dhe praktikës së besnikërisë ndaj një parimi: Hasani refuzon të shkurtojë trekëndëshin e dashurisë mes shërbëtorëve në shtëpinë e tij, duke pritur mundësi në të cilën zgjidhja do të shfaqet nga vetja në mënyrë që askush të mos jetë i mbingarkuar si dhe shfaq shqetësimin e tij të pasionuar për viktimat e kryengritjes në Posavina. Hasani në asnjë vend nuk ndihet si në shtëpinë e vet, as në Stamboll, as në Bosnjë. Pra, pasi shtëpia e tij nuk është askund, ai pajtohet që gjithmonë të udhëtojë. Kjo i mundëson Hasanit që të shpëtohet sepse ai asnjëherë nuk shkon deri në fund, ai ik nga rendi para se të shfaqen mungesat e tij duke mos pritur që ky rend t'ia sjellë vdekjen siç ia solli Nurudinit. Dhe në ndërkohë, strehim të përkohshëm ai gjen në dashuri. Ai sigurisht që di te jetojë më mirë sesa Nurudini, është i vetëdijshëm për natyrën kontradiktore të vlerave mes të cilave gjithmonë ka një zgjedhje, dhe njerëzit i kupton më mirë sesa dervishët. Ai nuk duket si dikush që mban rojë gjatë natës duke luftuar me demonët e tij dhe duke peshuar të ashtuquajturat parimet jetësore; ai tregon se aspekti i drejtpërdrejtë, i pasionuar pas jetës është e vetmja jetë reale që kemi.

Hasani, pra, më i mirë se Nurudini, di të jetojë. Por, a di ai se si të vdesë? Sepse, edhe Hasani do të vdesë një herë. Selimoviçi i ofron Nurudinit që para vdekjes të kthehet në hasanist dhe t'i paguajë gabimet e veta, në mënyrë që natën e fundit e ballafaqon me të birin e tij. Kjo është pika në të cilën heroi negativ ka një mundësi unike për t'u transformuar në një pozitiv, si Augustini apo Mersoja, dhe për t'u bërë një predikues i njohurive të reja – si hasanist. Hasanistët, njerëzit pa besim, nuk kanë zot që t'ia dorëzojnë jetën e tyre. Ata e duan jetën, i përmbahen asaj, bashkohen me ato që i duan. Pra vdekja, edhe pse është hyrje në asgjë, bëhet më pak e pakuptimtë, dhe jeta fillon ta ketë kuptimin e saj. Kishte mundësi që ky të ishte zbulimi i fundit i Ahmed Nurudinit, dhe si hasanist t'i transmetonte njohuritë e tij tek të tjerët.

Këtë ide edhe vetë Selimoviçi e mbron në shumë intervista. Por heroi i këtij rrëfimi nuk është i mashtruar nga kjo ide, duket se në disa çaste edhe e hedh poshtë atë në mënyrë

eksplicite. Në çastet e fundit të jetës Nurudini përshkruan takimin me djalin e vet. Edhe pse ndoshta do të ishte më e logjikshme që në këtë pjesë të veprimit, në momentin para vdekjes Nurudini ta krijojë dhe ta shkruajë filozofinë e tij jetësore, ndërsa për takimin me djalin e tij të shkruante vetë djali ose Hasani, Selimoviçi e lë atë ta përshkruajë këtë ngjarje ku ai me një emocion të thellë tregon se më nuk është i aftë për të dhënë dashuri dhe butësi. Këtu nuk reflektohet gjendja psikike e Nurudinit dhe vetëdija e tij, vetëm përshkruhet gjendja e vështirë, ai njoftohet me djalin e tij disa orë para se të shkojë në varr. Ai nuk e pranon hasanizmin, por është i vetëdijshëm se vdekja, çasti i tmerrshëm një ditë do të vijë jo vetëm te ai, por edhe te të gjithë të tjerët. Edhe pse autori mundohet që butësinë dhe dashurinë njerëzore ta paraqesë si një ndjenjë e domosdoshme humane, në fund kemi një paradoks-dashuria dhe butësia para vdekjes nuk kanë ndonjë rëndësi të madhe.

Pse, dhe kujt i rrëfëhet Nurudini deri në fund? Ai nuk ka një zot, të cilit do t'ia japë jetën, do t'i lutet dhe të kërkojë mëshirë dhe falje. Ai madje as nuk u drejtohet njerëzve me një kërkesë për ta ndjekur atë. Edhe pse udhëtimin e tij jetësor e ndan në mënyrë të qartë në disa faza – në rini, ai kishte kapacitet për dashuri dhe butësi, në moshën e rritur, pa dashuri dhe butësi, por me përkushtimin ndaj besimit dhe Zotit, dhe vitin e fundit të jetës së tij, ku ai humbi besimin dhe nuk e ktheu aftësinë për dashuri dhe butësi. Nurudini nuk krijon ndonjë marrëdhënie hierarkike mes tyre, gjë që do të na mundësonte të përcaktonim se çfarë është "pozitive" dhe çfarë është "negative" në jetën e tij.

Përveç kësaj, Nurudini mjaft qartë eliminon mundësinë që koha e rinisë, e dashurisë dhe butësisë të perceptohet si "pozitive" dhe çdo gjë tjetër ishte vetëm duke e larguar atë nga shpëtimi. Gjithashtu, Nurudin refuzon mundësinë për konvertimin e tij në hasanizëm: ai do të preferonte që të bëhet një gjyqtar dhe të provojë përsëri me sistemin rendor edhe pse vetë nuk kishte besim as në zot e as në qeveri. Prandaj, nuk ka asnjë zbulues që në zhanrin e rrëfimit lejon kalimin nga jeta negative në jetë pozitive. Nga rrëfimi i tij kuptojmë se Nurudini mbeti pa Zotin, pa ndjekës, pa zbulim, pa konvertim nga negativja në pozitive. Ai mbetet vetëm me rrëfimin e transmetuar dhe me vdekjen.

Me fjalinë e fundit që tingëllon si një thirrje vetëvrasëse na çon në pragun e idesë themelore të këtij romani nihilist, na tregon se çfarë ndodh me ata që nuk janë në gjendje të konvertohen, të cilët e dinë se në fund secili duhet të vdesë vetëm, si dhe të përgatitet për atë që vjen pas vdekjes.

Hasani gjithashtu e di se ka një lidhje mes rrëfimit dhe vdekjes, dhe e shpjegon këtë në historinë për një femër të nderuar që humbi djalin e saj. Ajo mban zi për djalin, dhe e kërkon vdekjen e vet. Kur Hasani e mashton se ai e njihte djalin e saj, ajo fillon të tregojë historinë e të birit, duke e ndjerë vetën të gjallë, dhe më nuk e kërkon vdekjen. Ekzistenca e saj, deri atëherë e drejtuar drejt vdekjes, mbushet me rrëfimin fikcional për birin e saj, ajo e gjallëron dhe e idealizon djalin e vdekur. Jeta e saj kthehet kur ajo fillon të fol për djalin e saj të vdekur. Edhe pse rrëfimet e saj janë të orientuara kah vdekja, ia kthejnë jetën. Gruaja vdes 3 vjet më vonë, por kjo nuk ndryshon asgjë. Ajo vdes si çdo njeri normal, pasi 3 vitet e fundit kalon një jetë të mbushur me tregime për birin e saj dhe ajo më nuk qëndronte me një gur në zemër duke e thirrur vdekjen. Me këtë histori, Hasani thotë se transmetimi i drejtuar nga vdekja as nuk e thirr vdekjen e as nuk e largon atë, por prodhon jetë.

Edhe Nurudini fillon të rrëfëhet në kohën kur hija e vdekjes bie në jetën e tij: kur vëllai i tij vritet, ai humb besimin tek ai që jep jetën dhe vdekjen. Rrëfimi është nxitur fillimisht nga nevoja e tij për të rivendosur rendin dhe transparencën në sistemin qeveritar e religjioz. Por, rrëfimi i tij më vonë i largohet këtij qëllimit pasi ai përsëri fillon të jetojë jetën e vet dhe në momentin kur bëhet kadi edhe pse qëllimi primar i tij është rendi dhe transparenca edhe ai e vazhdon punën e kadiut paraprak dhe prandaj më vonë edhe dënohet me vdekje. Edhe në këtë gjendje ai nuk humb shpresën. Ai thotë se e don jetën dhe brenda shpirtit të vet ka shumë jetë të cilën don ta përjetojë. Pra, ai nuk shtrihet me një gur të vështirë në gjoks, ai e don jetën dhe don ta jetojë atë, prandaj edhe shkruan deri në momentin e fundit të jetës pasi sipas tij njeriu jeton derisa shkruan dhe ka çfarë të tregojë. Këtu shohim ngjashmëri me gruan nga historia e Hasanit ku rrëfimi për djalin e vet ia riprodhon jetën asaj.

Nga kjo vepër nxjerrim një përfundim: Përpara vdekjes nuk kemi strehim as tek familja, as tek dashuria, gjëja e fundit që na mbetet është rrëfimi, shkrimi dhe tregimi, të cilët ndoshta nuk do na ndihmojnë, por do na mbushin zemrën me lumturi.

III.4 PERSONAZHET E TJERA NË ROMAN

Përveç personazhit kryesor, në roman kemi edhe shumë personazhe të tjerë, të cilët me veprimet, vendime dhe mendimet e tyre ndikojnë në jetën dhe përditshmërinë e protagonistit Ahmed Nuredini.

1. Kadiu Ajni Efendiu- kishte firmosur urdhrin për burgosjen e vëllait të dervishit. Në fund gjen vdekjen nga duart e pushtetit.
2. Gruaja e kadiut- në çdo çast mendohej të ndryshojë mendimin e dervishit. Ajo nga ai kërkon që ta ndihmonte në sjelljen në rrugë të drejtë të vëllait të saj Hasanit.
3. Babai i Ahmedit- personazh që shfaqet vetë një herë dhe edhe në atë shfaqje është i padrejtë, pasi mendon vetëm për djalin tjetër e me këtë rast ndikon në mendimet e Ahmedit për të menduar se ai për të është i vdekur dhe nuk trajtohet i njëjtë si me vëllanë e tij më të ri në moshë.
4. Haxhi Sinanudini- personazhi më pozitiv në roman, altruist, jep pasurinë për të varfrit dhe me anë të tyre jeta e tij merr kuptimin që duhet.
5. Hasani- vëllai i gruas së kadiut, i cili merrej me punë të këqija dhe e kalonte kohën më të madhe me një dubrovnikase, por më vonë kthehet në rrugën e drejtë dhe bëhet miku më i mirë i dervishit, duke e përkrahur atë në çdo vendim.
6. Ikanaku Isak- i ikur nga burgu, por nuk mund ta kuptojmë nëse ai ekziston vërtet pas dervishi e sheh atë edhe njëherë tjetër aty ku ai nuk është më.
7. Mulla Jusufi- student dhe spiun i kadiut

Kreu IV

IV.1 INTERTEKSTI KURANOR NË ROMAN

“Në kulturën tonë (lidnore) libri i shenjtë qëndror është Kurani, i cili mbase është libri i shenjtë i ndërtuar më sistematikisht në botë. Asnjë libër nuk ka ndikim të vet në letërsi, pa pasur vetë cilësi letrare, kurse Kurani është vepër e letërsisë, përderisa ajo studiohet nga kritika letrare”-shkruan studiuesi i madhe amerikan i letërsisë Northrop Fraji.

Kuran, Libri i katërt dhe më avansuari ka qenë dhe mbetet për çdo krijues të mirëfilltë gurrë e pashterur frymëzimi, fuqie dhe krijimtari letrare e artistike, prej së cilës kanë dalë vepra, të cilat kanë sublimuar në shkallën më të lartë ligjësitë e artit letrar. *Kurani*, apo që është libri më i lexuar dhe më i përkthyer në botë, ka bërë traditë të bujshme dhe ka ushtruar ndikim të pazëvendësueshëm në kulturën dhe krijimtarinë letrare artistike botërore mbetet një referencë e rëndësishme krijuese, madje metaforë krijuese dhe shpesh si një interktest letrare.

Vepra e quajtur *Kuran*, fjala e Zotit, është realizuar në forma dhe zhanre të ndryshme letrare: në këtë vepër voluminoz kemi tregime të ndryshme, histori vendesh e histori njerëzish, që shënojnë epoka të njohura, epope, poezi, madje poezi me trajta të pastërta lirike, legjenda të ndryshme, moralizime, ditarë, këngë, shumë prej tyre këngë dashurie shkruar në nivel të lartë estetik, të cilat në tërësi sublimojnë, në nivel brilant ligjësitë e artit poetik, edhe pse nuk janë shkruar me këtë destinim. Libri është i veçantë ndër librat e tjerë, për nga përmbajtja dhe për nga qëllimi. Bibla, për popullin bosnjak është para së gjithash vepër besimi, normash morale, ndërsa për kulturën botërore, vepër vlerash shumëdimensionale, vepër arti, që në vete ngërthen të gjitha zhanret letrare, format, tiparet e letërsisë si në poezi, ashtu edhe në prozë. Kurani ka stil të veçantë, figuracion, simetri, trajta, kulturë shkrimi. Karakteristikë e Kuranit, mbetet trajtat e prozës ritmike, që me ligjërim e përpunuar ritmik shpeshherë shkon kah natyra e poezisë.

Letërsia ballkanike, më saktë letërsinë të cilën e krijon Mesa Selimoviq më thekst të vecantë në romanin “Dervishi dhe vdekja”, paramodel e paratekst të parë ka hipotekstin kuranor, së këndejmi diskursin fetar - kuranor në të gjitha rrafshet e shkrimit letrar-estetik, për t’u derijvuar ky shkrim me shqiptime, në rrafshin e kodeve tematike e semantike, stilistike - estetike, në rrafshin e shprehjes letrare,, referencë e paramodel në nivel të shpërndërrimit të strukturës së brendshme e të jashtme letrare. Letërsia ballkanike, si shume letërsi të kombeve evropiane, do të nisë me shkrimet e shenjta” dhe do të zhvillohet në këto suaza deri me sot, prirja e së cilës ndaj kësaj reference mbetet e jashtëzakonshme. Së këndejmi, influenca, poetika e diskursit kuranor do të ndikojë edhe në rrjedhat e konsolidimit të gjuhës, kulturës dhe veçanërisht letërsisë boshnjake. Pa këtë paratekst letërsia shqipe s’do të ishte kjo që është. Kjo vetëm sa na e përforcon argumentin se Kurani është shkollë letrare brenda literaturës boshnjake dhe kjo do të argumentohet gjatë studimit të romanit” *Dervishi dhe vdekja*”.

Ashtu siç e përmenda edhe në fillim, çdo kapitull i veprës hapet me një varg kuranor dhe atë e shohim edhe në të gjitha faqet e romanit, të cilat autori i ka shkruar nga dhimbja e madhe që ka pasur për vëllanë e tij të vranë në Goli Otok, pra vepra ka elemente autoreferencijale pasi autori me vreasjen e vëllait të Dervishit pasqyron vrasjen që i behet vëllait të tij në jetën reale. Disa nga to do të përmenden edhe më poshtë:

1. *“Sikur të mund të dënonte zoti për çdo të keqe nuk do të kishte mbetur asnjë gjallesë në tokë”*.⁶¹
2. *“Ai që beson në zot dhe në ditën e Kiametit, nuk mban miqësi me armiqtë e Allahut dhe peygamberit të tij, makar qofshin ata prindërit, vëllezërit apo të afërmit e tyre”*.⁶²
3. *“Mos u bëj krah dhe ndihmë për të pabesët”*.⁶³
4. *“O besimtarë, mënjano huni dyshimeve dhe shpifjeve, sepse shpifja dhe dyshimi janë gjynahe”*.⁶⁴
5. *“Ruajeni farefisnin”*.⁶⁵

⁶¹ Mesha Selimoviç, (1966), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, Tiranë, f.17.

⁶² Po aty, f.160.

⁶³ Po aty, f.161.

⁶⁴ Po aty, f.161.

⁶⁵ Po aty, f.219.

6. “Nënshtroju zotit dhe pejgamberit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja”.⁶⁶
7. “Njeriu fiton kur jep”.⁶⁷
8. “Për njerëzit janë mundimet”.⁶⁸

IV.2 PËRMENDJA E ZOTIT NË ROMAN

Në çdo faqe të romanit ne e kemi emrin e zotit dhe atë e bën autori për të treguar për besimin e vetëm që kishte protagonist kryesor, dhe ai ishte i vetmi tek i cili dervishi mbështetej dhe gjente përgjigjet të cilat i kërkonte nga bota e shthurur dhe nga njerëzit keqbërës dhe tradhtarë.

IV.3 NGJASHMËRITË E ROMANIT ME VEPRA TË TJERA

Ky roman ka ngjashëri edhe me shumë romane të tjera nga shkrimtarë të tjerë, si për nga tematika ashtu edhe për nga vuajtjet dhe dhimbjet e personazhit kryesor. Romani ka ngjashmëri me romanin “**Procesi**” të Franz Kafkës⁶⁹. Këtu vihet re një e vërtetë tronditëse e realitetit me njeriun e thjeshtë brenda dhe sistemit që ndryshojnë dhe e shikojnë këtë të fundit si një pengesë apo si një të mirë për to. Një qytetar i thjeshtë dhe i rëndomtë, nëpunës banke nga një qytet i panjohur, e arrestojnë në mëngjes dy policë pa ndonjë arsye, për një krim që nuk i tregohet as atij dhe as lexuesit. Zoti-K nuk ka aftësi për të kuptuar sistemin megjithëse përpiqet që të kuptojë diçka, përsëri është i mbytur në paqartësi. Gjatë kësaj kohe njihet me mjegullinë e gjykatave, absurdin, hierarkinë e posteve jo vetëm në gjykatë, por edhe në jetën e mirëfilltë.”*Atëherë ai imagjinon marifete nga më të dëshpëruarat, që të zbulojë para tij ingranazhe të pakuptueshme dhe mbytëse. Duke mos ditur kujt t’i besojë dhe ku të kapet, ai ulet vetë të përpilojë mbrojtjen e vet, në të cilën kërkon falje për çdo gjë që ka bërë, duke firmosur kështu aktin e fajësisë dhe dënimit e vet.*⁷⁰ Kur shohim se sa vuan protagonistin në

⁶⁶ Po aty, f.252.

⁶⁷ Po aty, f.291.

⁶⁸ Po aty, f.416.

⁶⁹ Franc Kafka(1883-1924), nënshtetas austro-hungarez me prejardhje hebraike, shkrimtar

⁷⁰ Portalb.mb/228932-procesi-kur-nuk-ke-zgjidhje-tjetër-pos-të-shpallësh-i-fajshëm

duhet të kujtojmë thënien e Kafkës :- *“Vuajtja është element pozitiv i kësaj bote, në të vërtetë e vetmja lidhje midis kësaj bote dhe pozitives”*.⁷¹

Romani ka ngjashmëri edhe me romanin **“Gjenerali i ushtrisë së vdekur”** të Ismail Kadaresë⁷². Gjenerali këtu është ai që gjithmonë është në kërkim të eshtrave të ushtarëve italianë të rënë gjatë kohës së pushtimit të Shqipërisë. Kurse dervishi është gjithmonë në kërkim të së vërtetës dhe së drejtës, të cilat nuk ia jep askush.

Romani ka ngjashmëri edhe me tragjedinë **“Antigona”** të Sofokliut. Ajo, e cila doli kundër urdhrat të mbretit që të mos e varroste vëllanë e saj të vrarë, edhe dervishi e bën të njëjtën gjë, duke dalë kështu kundër ligjit dhe qeveritarëve, për ta varrosur vëllanë, në mënyrën që zoti e kërkonte dhe për t’iu prehë shpirti në paqe.

Ka ngjashmëri edhe me përmbledhjen poetike **“Lum Lumi”** të Ali Podrimjes, ku kemi dhimbjen e madhe që ndjen vetë autori për djalin e tij, i cili vuante nga një sëmundje e pashërueshme, dhe edhe dervishi ndjen dhimbje për të vëllanë e vrarë.

⁷¹ Mesha Selimoviç,(1966), *Dervishi dhe vdekja*, Papirus, Tiranë, f.118.

⁷² Ismail Kadare 1936), shkrimtar shqiptar nga Gjirokastra.

KREU V

V.1 HUAZIMET TURKE NË ROMAN SI INTERTEKST

Pasi autori përdor huazime nga gjuha turke, aty kemi dy arsye ose për të treguar që ka pasur ndikim gjuha osmane në letërsi dhe atë e sheh si përparësi duke përdorur fjalë që dëshmojnë pushtimin osman në atë kohë por edhe duke aluduar në atë që Perendoria Osmane ka qenë e madhe dhe ka sjellë qytetërimin e saj në vendet që ka pushtuar përveç imponimit të fesë islame.

Në shumë faqe të romanit të Mesha Selimoviçit ne ndeshemi me fjalë nga gjuha turke, gjegjësisht nga osmanishtja e vjetër, gjë të cilën e shohim shpesh edhe në shkrimet e shkrimtarëve të tjerë. Si te Ismail Kadare në romanin “Kështjella”. Disa nga fjalët turke që përdoren në roman do t’i shohim në tabelën më poshtë.

IX.1. TABELA E HUAZIMEVE TURKE NË ROMAN

Alim- njeri i ditur
Akçe- të holla
Asqer- ushtar
Argati-punëtori
Avash-ngadalë
Avllisë-dera e madhe e oborrit
Boll-shumica

Bahçe-oborr
Bajrak- flamur
Çardak- hapësirë e shtëpive të vjetra
Divanhane-paradhomë e madhe
Dizari-komandant i kalasë
Dynjaja- bota
Dushman- armik
Dekik- sekondë
Evlat- fëmijë
Gjynah- mëkat, faj , gabim
Hajmalia- duva e shkurtër prej një fetari që mbahet në trup
Hesapet- llogaritë
Haber- lajm
Hajër –mirësi
Jatak- vend për fjetje
Jeshil- i gjelbërt
Kudret sahati- ora e fatit
Kubure- pushkë e vogël
Kazan- enë e madhe prej metali dhe e rumbullakët

Mejteb- shkollë fillore fetare
Mezar- varr
Myezin- ai që ngjitet në minare dhe thërret njerëzit në xhami
Mulla- titull i atyre që mësonin në medrese
Myderiz- mësimdhënës në medrese
Mileti- populli
Miraz- pasuri
Mevlevi- sekt dervishësh
Minder- shtresë i mbushur me kashtë që vendoset sipër një shtrati të ulët prej dërrasash
Nami- fama
Nishanet- shenjat
Perçe- pëlhurë e zezë dhe e hollë, me të cilën gratë myslimane mbulojnë fytyrën
Qeder- dëm
Sokak- rrugë
Sebep- shkak
Surrat- fytyrë
Sabur- durim
Sevap- vepër e mirë humanizëm
Sahat- orë

Sheh- i pari një teqeje
Shejtan- djall
Tagri- detyrimi
Teqe- vendi ku rinë dervishët
Vakuf- pronë e xhamisë
Xhade- rrugë
Xhuma-e premtë
Zurnaja- instrument muzikor prej druri me frymë
Zindan- burg

V.2. KRAHASIMET E SHPESHTA QË I GJEJMË NË ROMAN

1. Krahasimi i Ahmed Nuredinit me Kabilin, atij të cilit zoti ia kishte dërguar korbin që ta rrëmihte në dhe, për të mësuar se si do të varroste trupin e vëllait të vdekur. Ai kishte thënë :-“Oh! Vaj medet për mua, vallë nuk mundem të bëj as si korbi, që të gropos trupin e vëllait tim të vdekur”. Korbi në këtë rast është element i zisë dhe i ndërgjegjesimit të njeriut.
2. Krahasimi i Ahmed Nuredinit me një dele të gjorë, e cila respektonte mendimin e tjetrit dhe i përkiste errësirës dhe verbërisë. Delja në këtë rast është turma që respektonte mendimin dhe urdhërin e kadiut.
3. Krahasimi i zemrës së Ahmed Nuredinit me një kazan të zjarrtë ku vlonte pija dehëse. Në këtë rast zemra e tij ishte e dehur nga loja, xhelozia dhe mashtrimet që i bëheshin.
4. Krahasimi që u bën Ahmed Nuredini kadiut dhe gruas së tij me akrepat gjakatarë. Në këtë rast ato ishin mbytësit dhe vrasësit e tij në mënyrë të fshehtë.
5. Krahasimi i të vdekurit me një fëmijë, me një shami të palosur dhe një tufë gruri. E krahason me një fëmijë pasi ai pranonte të shkonte ku t’i jepej urdhri, me një shami, pasi edhe i vdekuri palosej në një mënyrë të tillë. Jo vetëm palosja por edhe me shami pasi me humbjen e shpirtit kalon në materie ashtu siç është edhe çdo gjë tjetër që nuk ka shpirt.
6. Krahasimi që i bën dervishi jetës me një muranë. Edhe jeta për të pas vrasjes së vëllait kishte mbetur një muranë dhe ishte e vështirë të ndërtohej sërish, pasi mungonin pjesët elementare.
7. Krahasimi që i bën dervishi të drejtës me shëndetin. Njeriu e kërkon të drejtën ashtu si shëndetin vetëm kur i mungon ajo, kur nuk e ka dhe kur është e papërcaktuar.

8. Krahasimi i Ahmed Nuredinit me një skifter. Në këtë rast ka ngjashmëri më të sepse luftonte për një të drejtë dhe një të vërtetë. Ishte guximtar, kishte forcë, i gjithëpushtetshëm dhe i lartë me post. Janë keto krahasime që i bëhen personazhit kryesor në këtë rast dervishit i cili ka një karakter shumëdimensional dhe kompleks.

PËRFUNDIMI

Mesha Selimoviç krijoi personazhe të shumtë, të cilët ndikuan në letërsinë artistike dhe në jetën e përditshme të shumë lexuesve. Personazhet e tij nuk mund të frymonin lirshëm në botën e tyre, por megjithatë ishin personazhe që karakterizoheshin me ëndrrat e tyre dhe mendimet pozitive për të ardhmen e afërt. Ishin personazhe që në çdo hap paragjykoeshin nga të tjerët por, kjo ishte edhe si rezultat i rrethit shoqëror dhe ndikimit të kulturave të huaja, të cilat tashmë atë e kishin pjesë të së përditshmes dhe bota i njihnte me anë të tyre.

E studiuam personazhin e veçantë të Ahmedit dhe botën e tij të brendshme. Kuptuam se: "E kaluara duhet të vritet çdo ditë që kalon. Të fshihet është se nuk ekziston, se nuk dëmton. Do të ishte më lehtë të durosh një ditë që zgjat, nuk do të matet me atë që nuk ekziston më. Kështu përzihen fantazmat dhe jeta, kështu që nuk ka kujtesë të pastër ose jetë të pastër".

Personazhet e tij ishin luftëtarët e jetës që nga mëngjesi i hershëm e deri në natën e vonshme, kur armiku kishte mundësinë më të madhe të vepronte dhe të realizonte qëllimet e tij, kundër një populli të shtypur dhe që vazhdimisht mudohej të ishte nënshtrues i tyre edhe për një periudhë të caktuar kohore. Personazhet e tij harronin të gjitha gjërat tjera, por nuk harronin të drejtën që u përkiste atyre dhe dashurinë që armiku mudohej t'ua largonte e t'i bënte qenie pa vetëdije dhe pa një mbështetje, të cilën mund t'ua jepte vetëm familja dhe vëllai, siç e kemi në këtë rast me romanin në fjalë të autorit Selimoviç. Si përfundim siç thekson edhe profesor Arlind Farizi në studimin e tij për romanin "Dervishi dhe vdekja"⁷³ mund të themi se qëllimi i autorit është të ngjallurit e emocioneve të lexuesit dhe

⁷³ Arlind Farizi, *Letërsia e Europës juglindore 1*. Syth, Tetovë, 2019, f 43.

empatisë, të bërit e një lloj katarse dhe të afruarit e dashurisë që te njerëzit është larguar dhe harruar. Asnjë nuk mund dhe nuk duhet të nxjerrë përfundimin se romani nuk predikon shpresa. Kishte gjithmonë njerëz të pakënaqur dhe të paplotësuar, por kishte edhe njerëz që ishin në gjendje ta shihnin jetën në anën tjetër - më të plotë, më të gjallë dhe të gëzuar. Ata kishin ëndrra dhe çdoherë ishin me mendime pozitive edhe pse jeta i sfidonte me sfida që nuk mund mund t'i përballonin. Edhe pse një popull me kushte të rënda te ata përsëri kishte shpresë.

Romani “Dervish dhe vdekja” është vepra më domethënëse në veprën letrare të Mesha Selimoviqit, por edhe një vepër domethënëse në tërë letërsinë tonë sepse ajo ka herë është përkhyer dhe është dhënë si shfaqje teatrore në rolin Ahmedit. Ky tekst mund të konstatojmë se është i veçantë në stilin, gjuhën, filozofinë e jetës, analizën psikologjike dhe teknikën e formësimit. Sipas këtyre dhe shumë cilësive të tjera, ai i përket majës së prozës sonë romaneske.” Dervishi dhe vdekja” është romani i personazhit - nga fillimi deri në fund qendra është personi i Ahmed Nurudin, i cili shkruan biografinë e tij, dhe pikëpamja rrëfyese e jetës çoi në kuptimin shkatërrues se jeta kaloi në zbrazëti dhe e papërdorur, e kotë dhe e pakuptimtë, pa gjurmë të qarta. Ky është gjithashtu një roman psikologjik i formësuar si një rrëfim i një heroi i cili, në fund të rrugëtimit të jetës së tij, në pritje të vdekjes, zvogëlon ekuilibrin e tij të jetës. Ai është gjithashtu një roman filozofik në qendër të të cilit është njeriu si qenie morale dhe kuptimi i ekzistencës së tij.

Ky roman na mësoi se *“Dashuria është ndoshta e vetmja gjë në botë që nuk duhet të shpjegohet ose të kërkohet për një arsye”. Se”... gjithçka është e mundur, gjithçka është afër, vetëm një njeri nuk duhet të heqë dorë. Është e vështirë derisa të vendosni, atëherë të gjitha pengesat duken të pakapërcyeshme, të gjitha vështirësitë e pakapërcyeshme. Por kur shkëputeni nga vetvetiu i pavendosur, kur kapërceni dekurajimin tuaj, shtigje të paimagjinuara hapen para jush dhe bota nuk është më e ngushtë ose e mbushur me kërcënime”.*

Ky studim në nivel të magjistraturës, ka brenda vetës të gjitha argumentet e mundshme dhe bindëse se ky roman jo njëjtë si të gjithë librat në botë, flet për kërkimin e lumturisë, flijimin, dashurianë për vëllaun, fenë dhe zotin. Edhe pse fillimi qe pesimist:

vargjet e hidhura nga Kur'ani që rregullojnë punën thonë se çdo njeri është gjithmonë në humbje. Në rastin e studimit tonë, del se Dervishi, Shejh Ahmed Nuruddin, rrëfyesi dhe subjekti, pothuajse lirikisht, nuk gjeti asnjë lumturi. Përballë vdekjes, ai kërkon kuptimin e ekzistencës së tij, hap llogari me veten e tij, bën një përmbledhje të një lufte të tensionuar shpirtërore. Ai shkruan një rrëfim pikant, përshkruan përpjekjet e etura të vullnetit të tij, përballur me pakuptimësinë e jetës në tokë, çrregullimin dhe padrejtësinë, ndërsa përpiqet të ruajë dinjitetin e tij njerëzor. Kështu, në disa fjali, mund të përcaktohet tema kryesore e kryeveprës së Selimoviqit. Sidoqoftë, tema ka disa, ato zhvillohen paralelisht në një kornizë unike kompozicionale dhe konceptuale. Ky interpretim në studiimin tonë del se është një përpjekje për të hedhur dritë mbi temat kryesore dhe për të interpretuar kuptimin e së tërës. Jepet një përmbledhje e komplotit të romanit, përmes ritregimit, si dhe një analizë e personazheve. Çështjet narratologjike, si dhe prirje të caktuara joletrare, të tilla si kritika ndaj qeverisë së korruptuar, për shembull, nuk janë shmangur.

Në në fund, konstatojmë se situata metafizike në romanin "Dervishi dhe vdekja" është karakteristikë e ndjeshmërisë moderne. Transcendenca është përmbysur, rendi në botë është vënë në pikëpyetje. Dhimbja dhe malli për rendin e vjetër, i cili në fakt është vetëm një iluzion i rregullit, mbizotëron në vetëdijen e heroit, i cili e sheh mospërputhjen midis dy realiteteve si një çështje të brendshme dhe e sheh hendekun midis rendit të dëshiruar dhe kaosit që është realist si një çarje në shpirtin e tij. Personazhi i Ahmed Nuruddinit dëshiron të ikë përsëri në botën e vlerave dhe standardeve të përjetshme, por kjo nuk është më e mundur.

Ky personazh është më i bukur në letërsinë botërore...

Bibliografia

Barthes, Roland: *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë, 2008

Barthes, Roland: *Aventura semiologjike*, Prishtina, 1972

Cheval, Iv: *Letërsia e krahasuar*, Albin 2002, f. 28

Çabej, Eqrem: “*Për gjenezën e literaturës shqipe*”, Tiranë, 1937

Çapaliku, Stefan: *Estetika moderne*, SHBLU, Tiranë, 2006

Çaushti, Tefik: *Fjalor i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005

Dado, Floresha: *Intuitë dhe vetëdije kritike*, Onufri, Tiranë, 2006

Dado, Floresha: *Poetika*, SHBLU, Tiranë, 1999

Eko, Umberto: *Gjashtë udhëtime në pyjet narrative*, Asdreni, Shkup, 1997 (përktheu Bujar Hoxha)

Eko, Umberto: *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007

Hamiti, Sabri: *A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit*, Rilindja, Prishtinë, 1982

Hamiti, Sabri: *Albanizma*, ASHAK, Prishtinë, 2009

Hamiti, Sabri: *A-ZH Romanet e Nazmi Rrahmanit*, Prishtinë, 1982

Hamiti, Sabri: *Bioletra, Faik Konica*, Prishtinë, 2000

Hamiti, Sabri: *Letërsia modern shqiptare*, Prishtinë, 2000.

Hamiti, Sabri: *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë, 2005

Levi.Karlo.(1993), *Tokë e mohuar*, Flaka e vëllazërimit, Redaksia e botimeve Shkup, përktheu Flora Koka.

Mesha Selimoviç(1966), *Dervishi dhe vdekja*, përktheu Ben Andoni,Papirus,Tiranë

Roti.Nikolla.(1968), *Psikologjia e personalitetit*, Enti i botimeve shkollore i Republikës socialiste të Sërbisë, reparti Prishtinë.

- Sopaj, Nehas: *Rrëfimi në romanin shqiptar*, Shkupi, Shkup, 1996
- Sopaj, Nehas: *Rrëfimi në romanin shqiptar*, Shkupi, Shkup, 1996
- Syla, Sulejman: *Interkomunikimi letrar*, Rilindja, Prishtinë, 1990
- Shala, Kujtim: *Shekulli i letërsisë shqiptare*, Tiranë, 2004.
- Todorov, Cvetan: *Poetika e prozës*, Tiranë, 2000
- Tupja, Edmond. (2000), *Këshilla e një përkthyesi të ri*, Onfuri, Tiranë.
- Uçi, Alfred: *Estetika, jeta, arti*, Tiranë, 1970
- Uçi, Alfred: *Probleme të estetikës*, Rilindja, Prishtinë, 1980
- Uelek, Rene; Ostin, Ueren: *Teoria e letërsisë*, Tiranë 1993
- Uzeiri, Ilir: *Poetika*, Tiranë, 2000
- Vinca, Agim: *Alternativa letrare shqiptare*, Shkup, 2005
- Vinca, Agim: *Fije të pakëputura*, USHT, Tetovë, 2007
- Zhenet, Zherar: *Figura*, Rilindja, Prishtinë, 1985
- Zhiku, Ali: *Letërsia shqipe si polifoni*, “Dituria”, Tiranë, 2004
- Ковач, Никола: *Европски политички роман*, Ѓурѓа, Скопје, 2004
- Ќулавкова, Катица: *Теорија на интертекстуалноста*, Култура, Скопје, 2003.

BURIME NGA INTERNETI

www.forumishqiptar.com/threads/94861-çfarë-është-sufizmi

www.arkivalajmeve.com/Turqit-sjellin-Dervishi-dhe-vdekja.278438

portalb.mb/228932-procesi-kur-nuk-ke-zgjidhje-tjetër-pos-të-shpallesh-i-fajshëm/

BIBLIOGRAFIA PLOTËSUESE

Levi.Karlo.(1993), *Tokë e mohuar*, Flaka e vëllazërimit, Redaksia e botimeve Shkup, përktheu Flora Koka.

Roti.Nikolla.(1968), *Psikologjia e personalitetit*, Enti i botimeve shkollore i Republikës socialiste të Sërbisë, reparti Prishtinë.

Tupja. Edomond.(2000), *Këshilla e një përkthyesi të ri*, Onfuri, Tiranë.